



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
**MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT**

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MATURA SHETËRORE 2022

**RAPORT PUBLIK
MBI
ARRITJET E NXËNËSVE**

TIRANË, Dhjetor 2022

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	3
<i>Metodologjia</i>	4
<i>Gjetjet kryesore</i>	8
I Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe	16
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	16
2 <i>Arritjet e nxënësve në Letërsi dhe Gjuhë Shqipe - statistika krahasuese</i>	36
II Lënda: Matematikë	39
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	39
2 <i>Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese</i>	58
III Lënda: Gjuhë e Huaj	60
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	60
2 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese</i>	81
IV Lëndët me Zgjedhje	83
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	83
Shtojcë	124

Hyrje

Në përgjithësi, çdo sistem arsimor punon për të forcuar politikat për vlerësimin e nxënësve, vlerësimin e mësuesve ose edhe vlerësimin e shkollës, gjë e cila është shoqëruar me udhëzime të mëtijshme, mjete mbështetëse, mundësi të zhvillimit profesional dhe manual. Audienca kryesore e synuar nga këto politika kanë qenë mësuesit dhe drejtuesit e shkollave, por tashmë janë përfshirë edhe prindërit e nxënësit.

Adresimi i pabarazisë në të gjitha nivelet e sistemit është i nevojshëm në mënyrë që të ndërtohen sisteme arsimore cilësore. Për të siguruar të gjithë studentët të arrijnë aftësi të nivelit të lartë, barazia duhet të jetë përparësi në çdo aspekt të një sistemi arsimor. Përpjekjet e politikave duhet të synojnë të nxisin mjedise gjithëpërfshirëse të të mësuarit dhe/ose të shpërndajnë dhe të përdorin lloje të ndryshme të burimeve për të promovuar mundësi më të mira arsimore për të gjithë nxënësit.

Sigurimi i ofrimit të një shërbimi cilësor në arsim për të gjithë nxënësit kërkon një sërë ndërhyrjesh të politikëbërjes: parandalimi i përsëritjes së klasave; mësimdhënësit të jenë të pajisur me trajnime të duhura dhe njohuri pedagogjike për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit në rrugën e tyre të dijes; rritja e aksesit dhe sigurimin e arsimit të fëmijëve të hershëm të përballueshëm dhe me cilësi të lartë.

Ky raport publik shërben si material burimor për grupe të ndryshme interesi, ku ndër të parët renditim institucionet politikëbërëse të fushës së arsimit në nivel kombëtar dhe rajonal, më pas institucionet kërkimore, të cilat kërkojnë të dhëna për analiza, dhe së fundmi komunitetin e gjerë të prindërve të nxënësve, të cilët duan të monitorojnë se si shkollat ku studiojnë fëmijët e tyre po përparojnë në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënës.

Prej vitesh, në vendin tonë implementohet vlerësimi i jashtëm i njohurive të nxënësve maturanë, i cili tregon se ekzistojnë diferenca mes vlerësimit gjatë procesit mësimor dhe vlerësimit në maturë.

Edhe pse Raporti Publik - Matura Shtetërore 2022 - jep informacion që mundëson krahasimin e arritjeve të nxënësve mes ZVAP, theksojmë se, qëllimi kryesor i këtij raporti është njohja e nivelit të arritjeve të nxënësve maturanë të sistemit arsimor kombëtar në tërësi, bazuar në rezultatet e një vlerësimi të jashtëm të standardizuar, siç është Matura Shtetërore 2022, si edhe krahasimi i tyre me arritjet vjetore të nxënësve gjatë viti shkollor 2021-2022.

Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2022.

Për realizimin me sukses të Maturës Shtetërore 2022, QSHA përdor dy sisteme, të cilat janë:

- Matura Shtetërore, që përmban të gjithë rezultatet për provimet e detyruara të MSH 2022
- Maturanti, i cili përdoret për gjenerimin e certifikatave të MSH, si dhe gjenerimin e mesatares sipas VKM për pranimet në IAL.

Theksojmë se: rezultatet vjetore që kanë marrë nxënësit gjatë viteve të shkollimit, hidhen në këtë sistem nga mësuesit ose drejtuesit e shkollave; përgjithësisht shkollat kanë plotësuar dhe konfirmuar të dhënat për nxënësit, të cilët marrin diplomë dhe certifikatë të MSH. Nxënësit që nuk kanë notë vjetore të hedhur në sistem, rezultojnë të jenë:

- a) nxënës mbetës, qoftë edhe në një prej provimeve të MSH 2022, dhe shkollat nuk kanë konfirmuar notat e tyre, pra nuk janë të ruajtura në sistem.*
- b) nxënës që në maturë nuk e zhvillojnë atë lëndë/lëndët e MSH 2022, p.sh shkollat profesionale, gjimnazi me kohë të pjesshme, social - artistike.*

Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët letërsi dhe gjuhë shqipe, matematikë, gjuhë e huaj, si dhe lëndët me zgjedhje.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave të QSHA janë:

- numri identifikues i nxënësit (ID)
- gjinia e nxënësit
- ZVAP (së cilës i përket shkolla që ka frekuentuar nxënësi)
- lloji i shkollës (publike/private)
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet)
- profili i studimeve që ka ndjekur nxënësi (gjimnaz, gjimnaz gjuhësor, arsim profesional, social-artistik)
- sistemi i studimeve që ka ndjekur nxënësi (me kohë të plotë/me kohë të pjesshme)
- viti shkollor kur nxënësi ka mbaruar studimet e shkollës mesme
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor
- testet në provimet e maturës (që janë dhënë nga çdo nxënës)
- pikët e fituara në teste nga çdo nxënës
- notat në provimet e maturës shtetërore
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve, për testet e dhëna nga nxënësit në provimet e Maturës Shtetërore 2022, janë paraqitur:

- në nivel kombëtar
- në nivel ZVAP
- sipas urbanizimit – fshat/qytet
- sipas gjinisë - femra/meshkuj
- sipas profilit të shkollës që ka ndjekur nxënësi

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve maturan të vitit shkollor 2021-2022, të cilët morën pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2022. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore 2022, të klasifikuar sipas kategorive publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim		
		Total	Publik	Privat
1	Letërsi	30133	25801	4332
	Qytet	23677	19617	4060
	Fshat	6456	6184	272
2	Matematikë	30139	25805	4334
	Qytet	23677	19615	4062
	Fshat	6462	6190	272
3	Gjuhë e Huaj	30150	25819	4331
	Qytet	23686	19627	4059
	Fshat	6464	6192	272

Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim		
		Total	Publik	Privat
1	Letërsi	30133	25801	4332
	Femra	15349	13130	2219
	Meshkuj	14784	12671	2113
2	Matematikë	30139	25805	4334
	Femra	15353	13134	2219
	Meshkuj	14786	12671	2115
3	Gjuhë e Huaj	30150	25819	4331
	Femra	15346	13129	2217
	Meshkuj	14804	12690	2114

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet software-ve Statistika dhe SPSS.

Informacioni statistikor i përfshirë nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- mesatarja e pikëve të fituara në testim
- nota mesatare Vjetore - (NV)
- nota mesatare e Maturës - (NM)
- shmangia standarde –(shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre)
- nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk)
- nota mesatare e Maturës në nivel kombëtar - (NMk)
- kalueshmëria në provimin e Maturës

- diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk)
- diferenca e Notës së Maturës me Notën e Maturës në nivel kombëtar - (NM – NMk)
- diferenca e Notës së Maturës me Notën Vjetore - (NM – NV)

Statistika përmbledhëse për MSH 2022

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e Maturës Shtetërore 2022 për sesionin e qershorit, si dhe sesionin qershor dhe vjeshtë (të marra së bashku).

Numri i nxënësve në sesionin e qershorit dhe vjeshtës së bashku është më i madh, krahasuar me numrin e nxënësve në sesionin e qershorit, sepse në provimet e vjeshtës testohen jo vetëm ata nxënës që kanë mbetur në sesionin e qershorit, por edhe ata nxënës, të cilët kanë qenë mbetës gjatë vitit shkollor në një ose dy lëndë vjetore në maturën 2022.

Dhënia e lëndëve/provimeve në sesionin e vjeshtës, si nga nxënësit që kanë rezultuar mbetës në provimet e maturës në sesionin e qershorit, po ashtu edhe nga nxënësit mbetës në jo më shumë se 2 lëndë vjetore, ndikon në rritjen e kalueshmërisë, në përfundim të të gjithë procesit, të Maturës Shtetërore 2022

Nr.	Lënda e Provimit	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare Vjetore
		Total	Publik	Privat	(në %)		
Sesioni i Qershorit							
1	Letërsi	29100	24816	4284	99.75%	7.50	7.33
2	Matematikë	28190	23933	4257	98.49%	7.02	6.82
3	Gjuhë e Huaj	28786	24502	4284	99.30%	7.83	7.47
4	Lëndë me Zgjedhje	28646	24376	4270	98.75%	7.64	7.53
Të gjitha lëndët		114722	97627	17095	99.07%	7.50	7.29
Sesioni i Qershorit dhe Vjeshta							
1	Letërsi	30133	25801	4332	99.62%	7.46	7.27
2	Matematikë	30139	25805	4334	97.67%	6.91	6.74
3	Gjuhë e Huaj	30150	25819	4331	99.14%	7.75	7.38
4	Lëndë me Zgjedhje	30126	25793	4333	98.40%	7.54	7.44
Të gjitha lëndët		120548	103218	17330	98.71%	7.42	7.20

Statistika përmbledhëse për MSH 2021

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e Maturës Shtetërore 2021 për sesionin e parë, si dhe sesionin e parë dhe të dytë.

Nr.	Lënda e Provimit	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare Vjetore
		Total	Publik	Privat	(në %)		
Sesioni i Qershorit							
1	Letërsi	30856	26312	4544	99.00%	7.13	7.38
2	Matematikë	29793	25265	4528	98.89%	6.50	6.88
3	Gjuhë e Huaj	30543	26003	4540	99.05%	7.52	7.40
4	Lëndë me Zgjedhje	30783	26285	4498	99.05%	7.66	7.77
Të gjitha lëndët		121975	103865	18110	98.99%	7.20	7.36
Sesioni i Qershorit dhe Vjeshta							
1	Letërsi	32804	28142	4662	98.72%	7.00	7.27
2	Matematikë	32785	28127	4658	98.16%	6.40	6.75
3	Gjuhë e Huaj	32805	28142	4663	98.20%	7.38	7.31
4	Lëndë me Zgjedhje	32741	28111	4630	98.55%	7.54	7.69
Të gjitha lëndët		131135	112522	18613	98.40%	7.08	7.30

Statistika krahasuese për MSH 2022 dhe MSH 2021

Nga krahasimi i të dhënave me Maturën e vitit të kaluar, në sesionin e parë për të gjitha lëndët e MSH 2022 rezultojnë:

- kalueshmëria në provim, me një rritje prej 0.08 %
- nota mesatare në provimin e maturës, me një rritje prej 0.3 njësi note
- nota mesatare vjetore, me një rënie prej 0.07 njësi note

Nga krahasimi i të dhënave me Maturën e vitit të kaluar, në sesionin e parë dhe të dytë, për të gjitha lëndët e MSH 2022 rezultojnë:

- kalueshmëria në provim, me një rritje prej 0.31%
- nota mesatare në provimin e maturës, me një rritje prej 0.34 njësi note
- 7.29 nota mesatare vjetore, me një rënie prej 0.10 njësi note

Gjetjet kryesore

Ndër gjetjet kryesore të këtij raporti publik përmendim:

- ❖ Arritjet mesatare të nxënësve gjatë procesit mësimor janë më të ulëta, krahasuar me arritjet në provimet e Maturës Shtetërore 2022.
- ❖ Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve.
- ❖ Ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Arritjet mesatare të vajzave të qytetit janë më të larta, kundrejt arritjeve mesatare të vajzave të fshatit.
- ❖ Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës kundrejt arritjeve Vjetore, shihet se në lëndën Letërsi dhe Gjuhë Shqipe nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/meshkuj, si dhe qytet/fshat, ndërsa në lëndën e matematikës dhe gjuhës së huaj nxënësit e sistemit privat kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit publik.
- ❖ Dukuria e pranisë së rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore 2022 me një ndryshim prej më shumë ose më pak 2, 3 ose 4 nota kundrejt rezultateve vjetore të tyre, tregon për paqëndrueshmërinë e arritjeve të tyre.

Tabela e mëposhtme jep disa statistika lidhur me numrin e nxënësve që gjatë procesit mësimor janë vlerësuar me notën 10.00, si dhe sa prej tyre kanë marrë vlerësime 10.00 në një, dy, tre ose katër provimet e Maturës Shtetërore 2022, sipas ZVAP. Nga tabela rezulton se numri i nxënësve me të gjitha notat 10 gjatë viteve të shkollës së mesme është 1135 nga të cilët asnjë nxënës nuk ka marrë të gjitha provimet e maturës shtetërore notën 10.

Tabela tregon se, nga numri i nxënësve që janë vlerësuar me notën 10.00 gjatë procesit mësimor:

- asnjë prej tyre nuk ka arritur të marrë vlerësimin 10.00 në **katër** provimet e MSH 2022.
- 19 prej tyre kanë arritur të marrin vlerësimin 10.00 në **tre** provimet e MSH 2022.
- 89 prej tyre kanë arritur të marrin vlerësimin 10.00 në **dy** provimet e MSH 2022.
- 768 prej tyre kanë arritur të marrin vlerësimin 10.00 në **një** provim të MSH 2022.

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

Nr	ZVAP	Nr. i nxënësve me të gjitha 10 në të gjitha vitet e arsimit së mesme të lartë	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në 1 provim të MSH 2022	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në 2 provime të MSH 2022	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në 3 provime të MSH 2022	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në 4 provime të MSH 2022
1	BELSH					
2	BERAT	38	14	2		
3	BULQIZË	6				
4	CËRRIK	1	3			
5	DEVOLL	7	2			
6	DIBËR	3	5			
7	DIVJAKË	5				
8	DURRËS	102	70	5	1	
9	ELBASAN	39	18			
10	FIER	67	25	5	4	
11	FINIQ-DROPULL	5	9			
12	GJIROKASTËR-LIBOHOVË	18	8			
13	GRAMSH	2	3			
14	HAS	7	9	1		
15	KAMËZ	18	9			
16	KAVAJË	12	18	6		
17	KLOS	3				
18	KOLONJË	2				
19	KORÇË – PUSTEC	24	21	1		
20	KRUJË	12	7	1		
21	KUÇOVË	6	3			
22	KUKËS	21	23	3		
23	KURBIN	17	10	1		
24	LEZHË	32	22	1		
25	LIBRAZHD	5	1			
26	LUSHNJE	76	28	5		
27	MALËSI E MADHE	5	1			
28	MALIQ	3	2			
29	MALLAKASTËR	3				
30	MAT	5	3	1		
31	MIRDITË	6				
32	PATOS	1	2			
33	PEQIN	12	8			
34	PËRMET-KËLCYRË	4	1	1		
35	PËRRENJAS	15	4			
36	POGRADEC	39	11			

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

37	POLIÇAN	1	1	1		
38	PUKË-FUSHË ARRËZ	5				
39	ROSKOVEC	7				
40	RROGOZHINË	1				
41	SARANDË- DELVINË- KONISPOL	23	7			
42	SELENICË					
43	SHIJAK	1				
44	SHKODËR	44	64	7	2	
45	TEPELENË- MEMALIAJ	1				
46	TIRANË	343	325	44	12	
47	TROPOJË	2	1	1		
48	URA VAJGURORE	2				
49	VAU DEJËS	1				
50	VLORË- HIMARË	83	28	3		
51	VORË	3	1			
	TOTAL	1135	768	89	19	0

A) Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe

- Numri i nxënësve që morën pjesë në provim 30133
- Kalueshmëria në provimin e maturës 99.62%
- Mesatarja e pikëve të fituara në provim 36.84
- Nota mesatare në provimin e maturës 7.46
- Nota mesatare vjetore 7.27
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës 3.70%

Referuar rezultateve të provimit të Maturës 2022, nxënësit më të mirë paraqiten nxënësit e shkollave gjimnaz dhe gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh . Nxënësit që ndjekin shkollat gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh, kanë rezultate më të larta kundrejt nxënësve të profileve të tjera në rezultatet vjetore 2022.

Arritjet mesatare të nxënësve të sistemit publik janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet mesatare të nxënësve të sistemit privat.

Në sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e maturës janë 0.48 njësi notë më të ulëta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, kur ndërkohë, për nxënësit e sistemit

publik arritjet mesatare ndryshojnë me një vlerë prej 0.3 0 njësi notë. Pra rezulton se qëndrueshmëria e arritjeve mesatare të nxënësve është më e lartë në sistemin publik kundrejt sistemit privat.

Arritjet mesatare në Maturën 2022 si dhe ato vjetore 2022 të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt nxënësve të fshatit.

Arritjet mesatare të vajzave, në provimin e maturës, janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se vajzat kanë rezultate më të larta ndaj djemve. Vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, ashtu edhe në sistemin privat. Por, nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve në provimin e maturës, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se vajzat kanë marrë një vlerësim të ulët në rezultate në provimin e maturës, kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në maturë është 7.85 kundrejt 7.94 që është nota mesatare vjetore), në krahasim me djemtë, të cilët e kanë notën mesatare në maturë 7.05 kundrejt 6.57 që është nota mesatare vjetore.

Arritjet mesatare të nxënësve të qytetit janë më të larta, kundrejt arritjeve mesatare të nxënësve të fshatit. Mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth 4.84 pikë më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit. Ekzistenca e diferencës prej 4.84 pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të maturës, e cila arrin vlerën prej 0.62 njësi notë.

- 20 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Durrës, Vlorë-Himarë, Tiranë, Shkodër, Shijak, Korçë-Pustec, Has, Lushnje, Finiq-Dropull, Kurbin etj.
- 11 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga intervali **35** pikë deri në **36.79** pikë nga nxënësit e tyre **relativisht nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar si ZVAP: Lezhë, Pogradec, Fier, Devoll, Berat, etj.
- 32 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar si ZVAP: Klos, Skrapar, Malësi e Madhe, Bulqizë, Patos, Belsh etj.

Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, 6 e 7, dhe në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 8, 9 e 10.

Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 9 e 10, dhe në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 5 e 6.

B) Lënda: Matematikë

• Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	30139
• Kalueshmëria në provimin e maturës	97.67%
• Mesatarja e pikëve të fituara në provim	32.87
• Nota mesatare në provimin e maturës	6.91
• Nota mesatare vjetore	6.74
• Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës	11.06 %

Arritjet mesatare të nxënësve, në nivel kombëtar, në provimin e maturës janë më të larta krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.

Analiza e qëndrueshmërisë së arritjeve të nxënësve në provimin e maturës, kundrejt arritjeve vjetore, tregon se, për lëndën e Matematikës, nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të qëndrueshme, krahasuar me nxënësit e sistemit publik.

Nxënësit me arritjet më të larta për lëndën e Matematikës janë nxënësit që ndjekin shkollat e profilit gjimnaz, kjo për nivelin kombëtar, po ashtu edhe për sistemin publik. Ndërsa për sistemin privat të edukimit, nxënësit më të mirë janë nxënësit e shkollave gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh. Ndërsa, nxënësit me arritjet më të ulëta, në nivel kombëtar, janë nxënësit që ndjekin gjimnazin në sistemin me kohë të shkurtuar.

Arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të maturës dhe atë vjetore. Diferenca prej 9.64 pikësh e mesatares së pikëve mes sistemit privat dhe atij publik, tregon se, edhe për arritjet në lëndën e Matematikës, ka diferenca mes dy sistemeve arsimore që ekzistojnë në vendin tonë.

Arritjet mesatare të vajzave janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Në nivel kombëtar, mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth 5.17 pikë mbi nivelin e pikëve mesatare të fituara nga djemtë.

Arritjet mesatare të nxënësve të qytetit janë më të larta, kundrejt arritjeve mesatare të nxënësve të fshatit.

- 20 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Tiranë, Has, Peqin, Kurbin, Kavajë, Kukës, Gramsh, Tropojë, Rrogozhinë etj.
- 32 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Dibër, Shijak, Devoll, Patos, Fier, Berat, Lezhë, Elbasan etj.

Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, 6 e 7, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 8, 9 e 10.

Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 9 e 10, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 5 e 6

C) Lënda: Gjuhë e Huaj

• Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	30150
• Kalueshmëria në provimin e maturës	99.14%
• Mesatarja e pikëve të fituara në provim	39.53
• Nota mesatare në provimin e maturës	7.75
• Nota mesatare vjetore	7.38
• Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës	22.10%

*Arritjet mesatare të nxënësve, në nivel kombëtar, në provimin e maturës janë **më të larta** krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.*

*Arritjet mesatare më të larta për të gjitha gjuhët e huaja i **kanë arritur nxënësit e shkollave gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2 gjuhësh.***

Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 22.10 % e totalit të nxënësve, prej të cilëve vetëm 2.10 % i përkasin nxënësve të shkollave të fshatit.

Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor është 20.22 %, ku nxënësit e fshatit përbëjnë 2.6%.

Arritjet më të larta në provimin e Maturës Shtetërore u takojnë nxënësve, të cilët mësojnë gjuhë të huaj Anglisht (B2), Gjermanisht (B1) dhe Italisht (B2).

Mesatarja e pikëve të fituara në testim për gjuhën e huaj gjermane është 38.95 pikë, italisht 36.96 pikë, dhe anglisht (b2) 42.26 pikë.

D) Lëndët me Zgjedhje

• Numri i nxënësve që morën pjesë në provim	30126
• Kalueshmëria në provimin e maturës	98.40%
• Nota mesatare në provimin e maturës	7.54
• Nota mesatare vjetore	7.44
• Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës	18.91%

Niveli i kalueshmërisë në këto lëndë me zgjedhje është **mbi** 90%, ndër të cilat lënda Ekonomi dallohet për kalueshmëri 99.48%.

Pothuajse në gjitha lëndët me zgjedhje, **arritjet e nxënësve në provimin e Maturës janë më të larta kundrejt arritjeve vjetore.**

Në nivel kombëtar, nxënësit e qytetit kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e nxënësve të fshatit.

Nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të larta, referuar nxënësve të sistemit publik.

Në nivel kombëtar, vajzat kanë arritje më të larta sesa djemtë.

Më poshtë jepen disa të dhëna të përgjithshme për secilën nga lëndët:

Biologji: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 39.08 pikë. Kjo vlerë është pak më e lartë se gjysma e pikëve maksimale të testit. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e 0.59 njësi notë (8.36 – nota vjetore; 7.77 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit Privat të arsimit- kategoria fshat, ku vlera e kësaj difference shkon në 1.31 njësi notë (nota vjetore 9.14, ndërsa nota e maturës 7.83). Ulja e arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, në sistemin Publik, është e lartë për kategorinë e Femra-Fshat, ku diferenca NM-NV= -1.49 njësi notë.

Filozofi dhe Sociologji: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 34.23 pikë. Kjo vlerë është më pak se gjysma e pikëve maksimale të testit. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.19 njësi notë (7.32– nota vjetore; 7.13 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket kategorisë Privat-Qytet-Meshkuj, ku diferenca NM-NV= -0.77 njësi note.

Histori: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 31.37 pikë. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.67 njësi note (7.42 – nota vjetore; 6.75 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket kategorisë fshat-meshkuj, sistemi publik, ku vlera e kësaj difference NM-NV shkon në -3.35 njësi note (nota vjetore 8.4, ndërsa nota e maturës 5.05).

Fizikë: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është **44.71** pikë. Kjo vlerë është relativisht më e lartë se gjysma e pikëve maksimale të testit. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.60 njësi note (9.06 – nota vjetore; 8.46 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit publik të arsimit, kategoria fshat-femra, ku vlera e kësaj difference NM-NV shkon në -1.69 njësi note (nota vjetore 9.24, ndërsa nota e maturës 7.55).

Gjeografi: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është **30.90** pikë. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.12 njësi note (6.57 – nota vjetore; 6.69 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, ku vlera e kësaj difference NM-NV shkon në -2.03 (nota vjetore 7.30, ndërsa nota e maturës 5.27). Gjithashtu, vihet re se lënda Gjeografi për sa i përket sistemit privat të arsimit, është zgjedhur vetëm në kategorinë privat-qytet, pra nuk kemi asnjë nxënës në sistemin privat-fshat.

Kimi: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është **46.01** pikë. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.68 njësi note (9.26 – nota vjetore; 8.58 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notes vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit Privat të arsimit, kategoria Qytet-Femra, ku vlera e kësaj difference shkon në 1.60 njësi note (nota vjetore 9.63, ndërsa nota e maturës 8.03).

Qytetari dhe Psikologji: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 34.10 pikë. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.37 njësi note (6.76 – nota vjetore; 7.13 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit Privat, kategoria Fshat-Meshkuj të arsimit ku vlera e kësaj difference shkon në 0.98 (nota vjetore 6.5, ndërsa nota e maturës 7.48).


Ekonomi: Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 42.75 pikë. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 0.53 njësi note (7.75 – nota vjetore; 8.28 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit Publik të arsimit, kategoria Qytet/Meshkuj, ku vlera e kësaj difference NM-NV shkon në 1.07 (nota vjetore 7.05, ndërsa nota e maturës 8.12).

I. Lënda: Gjuhë shqipe dhe Letërsi

1) Arritjet e Nxënësve

Ndryshueshmëria e rezultateve vjetore, kundrejt rezultateve në provimin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë të Maturës Shtetërore 2022 është paraqitur në grafikët e mëposhtëm për çdo ZVAP, si dhe në nivel kombëtar. Dy

grafikët e mëposhtëm Gj-L – 1 dhe Gj-L – 2 tregojnë përqindjet e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”.



Si nivel mesatar është konsideruar kufiri mes notës shtatë dhe tetë. Për arritjet e Maturës Shtetërore 2022, në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - nën nivelin mesatar” është **46.99%** kundrejt **55.54%** në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - mbi nivelin mesatar” është **53.01%** për arritjet në provimin e Maturës Shtetërore kundrejt **44.46%** për arritjet vjetore. Grafiku tregon se, pothuajse të gjitha ZVAP, kanë diferenca mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e Maturës Shtetërore.

Tabela Gj-L – 1 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, si edhe sipas **sistemit publik/privat të arsimit**.

Tabela Gj-L – 1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	39.89	9.05	7.85	1.15	7.94	1.49
	Meshkuj	33.68	9.13	7.05	1.18	6.57	1.55
	Total	36.84	9.60	7.46	1.23	7.27	1.67
Qytet	Femra	41.02	8.65	7.99	1.13	8.04	1.48
	Meshkuj	34.77	8.86	7.20	1.18	6.69	1.56
	Total	37.87	9.29	7.59	1.22	7.36	1.67
Fshat	Femra	36.15	9.33	7.37	1.23	7.64	1.48
	Meshkuj	29.16	8.84	6.46	1.18	6.08	1.42
	Total	33.03	9.75	6.97	1.29	6.94	1.65
Publik total	Femra	39.15	9.08	7.75	1.16	7.76	1.46
	Meshkuj	32.78	8.91	6.94	1.16	6.32	1.44
	Total	36.02	9.55	7.35	1.23	7.05	1.62
Qytet	Femra	40.38	8.72	7.91	1.10	7.83	1.46
	Meshkuj	33.94	8.68	7.09	1.13	6.41	1.45
	Total	37.13	9.28	7.50	1.19	7.12	1.62
Fshat	Femra	35.64	9.18	7.31	1.19	7.56	1.46
	Meshkuj	28.62	8.47	6.39	1.12	5.98	1.35
	Total	32.50	9.53	6.90	1.24	6.86	1.62
Privat total	Femra	44.20	7.53	8.39	0.94	9.02	1.11
	Meshkuj	39.06	8.54	7.75	1.09	8.06	1.35
	Total	41.69	8.44	8.08	1.06	8.56	1.32
	Femra	44.00	7.63	8.36	0.95	9.00	1.12

Qytet	Meshkuj	38.85	8.58	7.72	1.09	8.04	1.35
	Total	41.46	8.51	8.05	1.07	8.53	1.33
Fshat	Femra	46.63	5.65	8.69	0.70	9.20	0.97
	Meshkuj	43.07	6.58	8.25	0.82	8.44	1.21
	Total	45.23	6.27	8.52	0.78	8.90	1.13

i. Në nivel kombëtar.

- mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Maturës Shtetërore në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë është **36.84** pikë, me shmangie mesatare **9.60**;
- nota mesatare e Maturës Shtetërore është **7.46** me shmangie mesatare **1.23**;
- nota mesatare vjetore është **7.27** me shmangie mesatare **1.67**.

Pra, në nivel kombëtar nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të Maturës Shtetërore, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.19 njësi note.

ii. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat.

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën Gj-L-1, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth **4.84** pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- Diferenca prej **4.84** pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të Maturës Shtetërore, e cila arrin vlerën prej **0.62** njësi notë.

iii. Arritjet sipas gjinisë

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.
- vajzat kanë marrë një vlerësim më të ulët në provimin e Maturës Shtetërore, krahasuar me arritjet vjetore të tyre (nota mesatare në Maturën Shtetërore është **7.85** kundrejt **7.94** që është nota mesatare vjetore), ndera djemtë kanë marrë një vlerësim

më të lartë në provimin e Maturës Shtetërore, krahasuar me arritjet vjetore të tyre (nota mesatare në Maturën Shtetërore është **7.05** kundrejt **6.57** që është nota mesatare vjetore)

- arritjet mesatare të vajzave në qytet janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të vajzave në fshat. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Maturës Shtetërore për vajzat në qytet është **4.87** pikë më e lartë, kundrejt vajzave në fshat.
- vajzat në qytet kanë një notë mesatare vjetore më të lartë, krahasuar me notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore (**0.05** njësi note më të lartë). Ndërsa vajzat në fshat kanë një notë mesatare vjetore më të lartë, krahasuar me notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore (**0.27** njësi note më të lartë).
- djemtë në qytet kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e djemve në fshat.
- në sistemin privat rezulton që diferencat mes arritjeve të vajzave në qytet, me ato në fshat, janë më të ndryshme: vajzat në sistemin privat, në fshat, kanë **2.63** pikë më shumë në mesataren e përgjithshme të pikëve të vajzave në qytet. E njëjta gjë qëndron edhe për kategorinë djem, me diferencën **4.22** pikë.

iv. Arritjet sipas sistemit publik/privat të arsimit.

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe mes dy sistemeve arsimore: publik e privat. Nga të dhënat e tabelës Gj-L-1 rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik. Kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të Maturës Shtetërore dhe atë vjetore.
- ekzistenca e diferencës prej **5.67** pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të Maturës Shtetërore, e cila arrin vlerën prej **0.73** njësi notë.

v. Qëndrueshmëria e arritjeve.

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore, kundrejt arritjeve vjetore, shihet se:

- nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit privat.
- në sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e Maturës Shtetërore janë **0.48** njësi notë më të ulëta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, kur ndërkohë, për nxënësit e sistemit publik, arritjet mesatare ndryshojnë me një vlerë prej **0.30** njësi notë.

Pra rezulton se qëndrueshmëria e arritjeve mesatare të nxënësve është më e lartë në sistemin publik kundrejt sistemit privat.

Tabela Gj-L-2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas **profilit të shkollës së ndjekur**, si dhe sipas **llojit të shkollës publike apo private**.

Tabela Gj-L – 2

	Profili i shkollës	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
TOTAL	Gjimnaz	37.54	9.78	7.54	1.25	7.51	1.66
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	37.27	10.08	7.51	1.28	7.55	1.53
	Artistike; Koreografike, Sportive	36.14	7.95	7.38	1.02	6.63	1.31
	Teknike profesionale	34.05	8.02	7.11	1.04	6.23	1.25
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	30.91	6.85	6.71	0.91	5.68	0.76
PUBLIK	Gjimnaz	36.70	9.80	7.44	1.26	7.29	1.64
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	37.16	10.09	7.50	1.28	7.53	1.64
	Artistike; Koreografike, Sportive	36.14	7.95	7.38	1.02	6.63	1.31
	Teknike profesionale	33.38	7.73	7.03	1.00	6.09	1.13
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	30.91	6.85	6.71	0.91	5.68	0.76
PRIVAT	Gjimnaz	41.76	8.50	8.08	1.07	8.62	1.29
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	44.80	5.18	8.47	0.62	9.13	1.12
	Artistike; Koreografike, Sportive	-	-	-	-	-	-
	Teknike profesionale	40.91	7.79	7.98	0.99	7.75	1.37
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	-	-	-	-	-	-

Bazuar në të dhënat e Tabelës Gj-L-2, për totalin e nxënësve dhe kategorinë publik/privat rezultojnë se:


- nxënësit që ndjekin shkollat gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh, kanë rezultate më të larta, kundrejt nxënësve të profileve të tjera në rezultatet vjetore 2022.
- ndërsa, referuar rezultateve të provimit të Maturës Shtetërore 2022, me rezultate më të mira paraqiten nxënësit e shkollave gjimnaz dhe shkollave gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2 gjuhësh, me një diferencë prej 0.27 në mesatare pikësh dhe 0.03 në notë mesatare, ndërmjet tyre.
- referuar sistemit publik/privat, rezultojnë se në të dy sistemet arritjet më të larta i kanë nxënësit e profilit gjimnaz – gjuhësor dhe seksionit dy gjuhësh.

Tabela Gj-L-3, Tabela Gj-L-4, Grafiku Gj-L-3 e Grafiku Gj-L-4, japin shpërndarjen e notave (në përqindje) të provimit të Maturës Shtetërore dhe notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.

Tabela Gj-L – 3

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.30%	4.98%	10.87%	18.09%	23.49%	18.65%	3.40%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.00%	0.12%	0.40%	0.64%	0.55%	0.53%	0.14%
3	Artistike; Koreografike, Sportive	0.00%	0.06%	0.21%	0.46%	0.52%	0.18%	0.02%
4	Teknike profesionale	0.08%	0.74%	2.34%	5.08%	3.56%	1.18%	0.13%
Në nivel kombëtar (dita)		0.37%	5.90%	13.81%	24.28%	28.13%	20.54%	3.69%
5	Gjimnaz -me kohë të shkurtuar	0.01%	0.32%	0.84%	1.47%	0.59%	0.05%	0.01%
Në nivel kombëtar		0.38%	6.22%	14.66%	25.74%	28.72%	20.59%	3.70%

Grafiku Gj-L – 3



Shpërndarja e notave (në përqindje) të provimit të Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.

Në nivel kombëtar, në provimin e Maturës Shtetërore:


- kalueshmëria është **99.62%**;
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 8** me **28.72%**;
- **notat 6, 7 dhe 8** kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth **69.12%** të totalit të nxënësve;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** në provimin e Maturës Shtetërore është **3.70%**.

Arritjet vjetore të paraqitura në Tabelën Gj-L-4 tregojnë se përqindja e lartë e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** ka arritur vlerën prej **13.71%** të nxënësve. Diferenca mes numrit të nxënësve të vlerësuar me **notën 9**, kundrejt atyre me **notën 10**, është afërsisht **0.67%** më shumë.

Tabela Gj-L – 4

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave Vjetore (në %)						
		Pa notë nga shkolla	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.02%	13.22%	12.52%	13.63%	14.25%	13.18%	12.95%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.00%	0.26%	0.43%	0.51%	0.42%	0.39%	0.36%
3	Artistike; Koreografike, Sportive	0.00%	0.34%	0.42%	0.35%	0.18%	0.12%	0.04%
4	Teknike profesionale	0.01%	4.22%	4.24%	2.23%	1.38%	0.67%	0.36%
Në nivel kombëtar (dita)		0.03%	18.04%	17.62%	16.72%	16.23%	14.37%	13.71%
5	Gjimnaz –me kohë të shkurtuar	0.00%	1.52%	1.24%	0.37%	0.14%	0.01%	0.00%
Në nivel kombëtar		0.03%	19.56%	18.86%	17.09%	16.37%	14.38%	13.71%

Grafiku Gj-L – 4



Shpërndarja e notave (në përqindje) vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.

Në nivel kombëtar, në notat Vjetore:

- kalueshmëria është **99.97%**;
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 5** me **19.56%**;
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** në notat Vjetore është **13.71%**.

Të dhënat mbi përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit qytet/fshat**, si dhe **gjinisë femra/meshkuj**, për provimin e Maturës Shtetërore 2022 dhe për arritjet Vjetore 2022, janë dhënë në formë tabelare dhe grafike, përkatësisht në **Tabelën GJ-L-5** dhe **Tabelën GJ-L-6** dhe grafikët **GJ-L-5** dhe **GJ-L-6**.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

LETËRSI

**Matura
Shtetërore 2022**

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Nota 4	0.18%	0.20%	0.38%
Nota 5	2.66%	3.55%	6.22%
Nota 6	4.72%	9.94%	14.66%
Nota 7	5.87%	19.87%	25.74%
Nota 8	4.95%	23.76%	28.72%
Nota 9	2.71%	17.88%	20.59%
Nota 10	0.33%	3.37%	3.70%


Tabela Gj-L-5

Vjetore 2022

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Pa notë	0.01%	0.02%	0.03%
Nota 5	6.00%	13.56%	19.56 %
Nota 6	4.10%	14.77%	18.86%
Nota 7	3.33%	13.76%	17.09%
Nota 8	3.20%	13.17%	16.37%
Nota 9	2.72%	11.65%	14.38%
Nota 10	2.06%	11.65%	13.71%


Tabela Gj-L-6

Grafiku Gj-L-5



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për provimin e Maturës Shtetërore 2022

Grafiku Gj-L-6



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për arritjet vjetore 2022

Nga tabela vërejmë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e Maturës Shtetërore, është **3.70 %** e totalit të nxënësve, ku **0.33%** janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, dhe **3.37 %** janë nxënës që i përkasin kategorisë qytet.

- Rezultatet e fituara në Maturën Shtetërore 2022, si dhe ato Vjetore 2022, për nxënësit e shkollave të qytetit, janë më të larta, kundrejt nxënësve të fshatit.
- Përqindja e nxënësve që kanë marr notën **10** në Maturën Shtetërore, për të dyja kategoritë, është më e vogël nëse do ta krahasonim me arritjet vjetore. Por rënia e kësaj përqindjeje për nxënësit e qytetit është shumë më e madhe krahasuar me rënien e kësaj përqindjeje në fshat.
- Ka një diferencë të dukshme midis nxënësve në qytet që kanë marrë gjatë vitit notën **10 (11.65%)**, krahasuar me atë në fshat (**2.06%**). Kjo diferencë midis dy grupeve është më e vogël në Maturë Shtetërore.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

LETËRSI

Matura Shtetërore 2022

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Nota 4	0.07%	0.31%	0.38%
Nota 5	1.74%	4.48%	6.22%
Nota 6	4.51%	10.14%	14.66%
Nota 7	10.40%	15.34%	25.74%
Nota 8	16.57%	12.15%	28.72%
Nota 9	14.65%	5.94%	20.59%
Nota 10	3.00%	0.70%	3.70%


Tabela GJ-L-7

Vjetore 2022

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Pa notë	0.01%	0.02%	0.03%
Nota 5	2.72%	16.84%	19.56%
Nota 6	7.65%	11.21%	18.86%
Nota 7	9.56%	7.53%	17.09%
Nota 8	10.49%	5.88%	16.37%
Nota 9	10.08%	4.30%	14.38%
Nota 10	10.43%	3.28%	13.71%


Tabela GJ-L-8

Grafiku Gj-L-7



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për provimin e Maturës Shtetërore 2022

Grafiku Gj-L-8



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për arritjet vjetore 2022

Nga të dhënat e paraqitura në **Tabelën GJ-L-7** dhe **Tabelën GJ-L-8**, vihet re se **vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e Maturës Shtetërore.**

Sipas analizës së bërë, për grupin e nxënësve të vlerësuar me notën **10**, gjatë vitit shkollor 2021-2022, vihet re se qëndrueshmëria e arritjeve, është më e lartë tek djemtë.

Numri i djemve të vlerësuar me notën **10** gjatë vitit shkollor, që kanë ruajtur të njëjtin rezultat edhe në provimin e Maturës Shtetërore, është më i madh, në krahasim me numrin e vajzave që kanë ruajtur vlerësimin me notën **10** edhe në provimin e Maturës Shtetërore.

Nga të dhënat e **Tabelave GJ-L-5-6-7-8**, për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, sipas rezultateve të arritura në provimin e Maturës Shtetërore, rezulton se:

- ka një përqindje më të lartë të mbetësve për kategorinë “meshkuj”, krahasuar me kategorinë “femra”;
- ka një përqindje dominuese të nxënësve që kanë marrë notat **7, 8, 9** e **10**, të kategorisë “qytet”, kundrejt kategorisë “fshat”;
- ka një përqindje dominuese të nxënësve që kanë marrë notat **8, 9** e **10** të kategorisë “femra”, kundrejt kategorisë “meshkuj”.

Nga të dhënat e analizuara më lart, rezulton se arritjet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore 2022 karakterizohen nga **“paqëndrueshmëria”**, duke i krahasuar ato me arritjet Vjetore 2022. **Tabela Gj-L-9** jep informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve Vjetore 2022 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2021-2022), të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës Shtetërore 2022, për lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë.

Tabela GJ-L-9

Notat vjetore (në %)		Notat e Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
pa notë	0.03%	0.00%	0.00%	0.01%	0.01%	0.00%	0.01%	0.00%
5	19.56%	0.31%	3.81%	6.98%	6.49%	1.84%	0.14%	0.00%
6	18.86%	0.07%	1.69%	4.57%	7.78%	4.14%	0.60%	0.02%
7	17.09%	0.00%	0.56%	2.12%	5.94%	6.61%	1.80%	0.06%
8	16.37%	0.00%	0.14%	0.78%	3.75%	7.63%	3.83%	0.24%
9	14.38%	0.00%	0.02%	0.16%	1.43%	5.68%	6.39%	0.71%
10	13.71%	0.00%	0.00%	0.03%	0.34%	2.83%	7.83%	2.68%
Gjithsej	100.00%	0.38%	6.22%	14.66%	25.74%	28.72%	20.59%	3.70%

Tabela Gj-L-9 lexohet si më poshtë:


- ❖ Nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor, vetëm **13.71%** e tyre kanë marrë notën **10**, në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, ndërkohë që, nxënësit, që edhe në provimin e Maturës Shtetërore e kanë ruajtur vlerësimin me notën **10**, është **2.68%** e totalit të nxënësve.
- ❖ Nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në provimin e Maturës Shtetërore, duhet të rezultonin **13.71%** nota **10** në nivel kombëtar. Ndërkohë, ka ndodhur që nxënës të vlerësuar me **10** në procesin mësimor vjetor, në provimin e Maturës Shtetërore 2022 janë vlerësuar me notën **6 (0.03%)**, notën **7 (0.34%)**, notën **8 (2.83%)**, notën **9 (7.83%)** dhe notën **10 (2.68%)**.
- ❖ Këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notën **10** gjatë vitit shkollor, në provimin e Maturës Shtetërore janë vlerësuar edhe me notën **6, 7, 8** apo **9**. Pra, vlerësimi i tyre është ulur me 2-3 nota, por ka raste kur ulja e vlerësimit është edhe me 4 nota.

Të dhënat e Tabelës Gj-L-9 tregojnë se një përqindje e caktuar e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5 e 6, në provimin e Maturës Shtetërore kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8 e 9.

Nga **18.86%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën **6**, vetëm **4.57%** e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin e Maturës Shtetërore. Ndërsa, ka prej tyre që në provimin e Maturës Shtetërore kanë marrë edhe vlerësime me mbi 2, 3 apo më shumë nota. (Kategoria “pa notë vjetore” tregon se në databazën e QSHA për disa nxënës nuk ka notë vjetore, shih: Metodologjia) .


Grafiku Gj-L-9 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e Maturës Shtetërore 2022, në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje normale të arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore.

Grafiku Gj-L-9



Shpërndarja e pikëve të fituara në provimin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku Gj-L-10



Shpërndarja kumulative të pikëve të fituara në provimin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku **Gj-L-10** tregon se:

- **0.01 %** e nxënësve janë vlerësuar me **60 pikë**;
- **0.05%** e nxënësve janë vlerësuar me **59 pikë**;
- **0.23%** e nxënësve janë vlerësuar me **57 pikë**;
- **0.11%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 10 pikë**;
- **0.85%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 15 pikë**;
- **13.75%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 25 pikë**;
- **26.96%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 30 pikë**;
- **54.28%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 38 pikë**;
- **92.92%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 50 pikë**.

Rezultatet e përftuara në përfundim të testit, na ndihmojnë të nxjerrim përfundime të qarta për nivelin e arritjeve të nxënësve në testin e **Gjuhës shqipe** dhe **letërsisë**, në MSH 2022.

Mund të bëjmë një klasifikim të rezultateve të arritjes në parametrat: *dobët, mjaftueshëm, mirë, shumë mirë* dhe *shkëlqyeshëm*, të cilat do të zëbrahen në 3 (tri) nivelet e arritjes, sipas programit të Maturës Shtetërore 2022:

- **Dobët** (përfshihen nxënësit që **nuk kanë arritur** të fitojnë mjaftueshëm rezultatet që përfshihen në **nivelin e parë** të arritjeve dhe janë vlerësuar në testin e MSH 2022 me **notën 4**).

- Sipas statistikave (Grafiku Gj-L- 10) rezulton se **0.11 %** e nxënësve janë vlerësuar brenda kufirit të këtyre arritjeve (ata kanë mundur të marrin nga **0-10 pikë**). Kjo do të thotë që ky grup nxënësish nuk e kanë kapërcyer **nivelin minimal** të arritjeve. Ata **NUK** kanë qenë të aftë të:
 - përdorin njohuritë paraprake për të kuptuar tekstin;
 - parafrazojnë informacionin ose idetë e tekstit;
 - identifikojnë elementet pamore (fotografi, ilustrime) të përdorura në tekstet e shkruara për të arritur qëllime të caktuara;
 - identifikojnë ndonjë prej karakteristikave të formës së teksteve, si: hyrja, mbyllja, paragrafi, fragmenti;
 - identifikojnë ndonjë prej karakteristikave përmbajtësore të teksteve.
- **Mjaftueshëm** (përfshihen nxënësit që kanë rezultate të **nivelet të parë** të arritjeve, nivel që përkon me **notat 5 dhe 6**).
- Nga grafiku Gj-L 10 vërehet që **0.85 %** e nxënësve kanë marrë pikë brenda intervalit **0 – 15 pikë**. Le të specifikojmë shpjegimet, nisur nga kompetencat e lëndës. Gjatë kësaj analize vërejmë se ky grup nxënësish kanë siguruar arritjet e mëposhtme:
 - **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit **kanë mundur** të:
 - përdorin njohuritë për të kuptuar në mënyrë **shumë të përgjithshme** tekstin (vetëm në linjën kryesore të tij);
 - evidentojnë të dhënat kryesore që përdor autori në mbështetje të idesë së tij;
 - lexojnë drejt shpjegimet në fjalorin e gjuhës shqipe;
 - identifikojnë informacionet më të rëndësishme të tekstit;
 - gjejnë shembuj në tekst që ilustrojnë tematikën kryesore të fragmentit;
 - **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit **kanë tentuar**:
 - t'i përmbahen temës së esesë;
 - të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit
 - **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **kanë mundur** të:
 - dallojnë klasat më kryesore të fjalëve.
 - të dallojnë klasën e mbiemrave; pasthirrmat
 - **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Në këtë rast nxënësit e këtij grupi **kanë tentuar** të:
 - identifikojnë ngjarjen kryesore;
 - identifikojnë personazhin kryesor.
- Nga grafiku Gj-L 10 vërehet që **13.75%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 25 pikë**.

Ky grup nxënësish, kanë siguruar përveç arritjeve të mësipërme, edhe rezultatet e mëposhtme, sipas kompetencave përkatëse:

- **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit në këtë rast:
 - identifikojnë hyrjen apo mbylljen e tekstit;
 - parafrazojnë në mënyrë **sipërfaqësore** informacionet kryesore të tekstit;
 - dallojnë shkaqet nga pasojat në tekst;
 - përzgjedhin alternativën e saktë për tiparet e poemës romantike;
 - zbulojnë kuptimet e drejtpërdrejta të fjalës;
 - zbulojnë tonin në replikat e personazheve.
- **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit **kanë arritur** të:
 - shtjellojnë **deri në një farë mase** idenë e një paragrafi;
 - të ndërtojnë **pjesërisht** strukturën e esesë.
- **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **munden** të:
 - dallojnë ndërtimin e fjalës;
 - zbulojnë sinonimet në një kontekst të caktuar;
 - dallojnë elipsën si figurë letrare;
 - dallojnë antonimet në tekst;
 - dallojnë rendin e përmbysur në një fjali.
- **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Nxënësit kanë mundur të:
 - dallon qëndrimin e autorit ndaj temës që trajton;
 - identifikojnë motivin kryesor;
 - zbulojnë gjendjen shpirtërore të personazhit.
 - të zbulojnë tonin në replikat e personazheve
- **Mirë** (përfshihen nxënësit që kanë fituar **nivelin e dytë** të arritjeve, që përkon me notat 7-8).
- Sipas të dhënave të paraqitura në Grafikon Gj-L-10, **26.96%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 30 pikë**.
Këta nxënës, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:
 - **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit **janë të aftë** të:
 - shpjegojnë kuptime të caktuara të tekstit;
 - shpjegojnë organizimin e koherencës në fragmente të ndryshme të tekstit;
 - bëjnë parashikime duke u bazuar te titulli i pjesës.
 - **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit **kanë arritur** të:
 - organizojnë fakte dhe ide në përshtatje me qëllimin e esesë.

- **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **kanë aftësinë** të:
 - shpjegojnë përshtatjen e emrit me mbiemrin;
 - ndërtojnë fjali të përbëra nga grupe fjalish të thjeshta;
 - shpjegojnë nevojën e burimeve të informacionit në një tekst.
- **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Nxënësit **munden** të:
 - shpjegojnë raportet mes personazheve në tekst;
 - shpjegojnë raportet mes narratorit dhe lexuesit në varësi të **vetës së komunikimit**;
 - shpjegojnë shkaqet e gjendjes shpirtërore të personazheve në fragment;
 - analizojnë figura të thjeshta letrare.
- Nga grafiku Gj-L 10 vërehet që **54.28%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 38 pikë**.
Ky grup nxënësish kanë **EDHE** arritje të tjera, të renditura më poshtë, sipas kompetencave.
 - **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit **dëshmojnë përpjekje** teksa:
 - analizojnë modelet organizative të tekstit jo letrar;
 - analizojnë idetë e tekstit;
 - analizojnë tekstin nga pikëpamja stilistikore;
 - analizojnë veçoritë gjuhësore të tekstit (p.sh., funksionin e përdorimit stilistik të thonjzave) në tekst.
 - **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit **kanë arritur** të:
 - mbështetin argumentet e esesë me detaje e shembuj personalë;
 - shtellojnë idenë e paragrafit zhvillues të esesë me shembuj e përshkrime;
 - rimarrin idenë kryesore në paragrafin e fundit të shkrimit, si mbyllje e esesë.
 - **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **kanë aftësinë** të:
 - ndërtojnë fjali të sakta nga pikëpamja sintaksore;
 - shpjegojnë marrëdhëniet kuptimore dhe lidhjet sintaksore që realizohen në fjalinë përbërë;
 - përdorin drejt trajtën e shkurtër në fjali.
 - **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Nxënësit **kanë mundur** të:
 - analizojnë aspekte të veçanta të tekstit që lidhen me imazhe të përfuara nga përdorimi i figurave letrare në fragment;
 - shpjegojnë raporte mes personazheve apo skenave të veçanta në tekst;
 - analizojnë gjuhën e figurshme të tekstit (organizimin e sintaksës poetike të tekstit).

- **Shumë mirë** (përfshin **nivelin e tretë** të arritjeve, që përkon me notat **9** dhe **10**).
- Sipas të dhënave të Grafikut Gj-L-10, **92.92%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 50 pikë**.
Këta nxënës, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë **EDHE** aftësitë e mëposhtme:
 - **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit:
 - interpretojnë ndikimin që ka aspekti stilistikor në një tekst joletrar;
 - bëjnë lidhjen mes tekstit dhe ideve të tjera jashtë tekstit në një situatë të re.
 - **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit **kanë arritur** të:
 - përdorin strategji personale për të bindur lexuesin;
 - përpiqen të jenë origjinalë në trajtimin e temës së esesë.
 - **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **kanë aftësinë** të:
 - formojnë fjali të llojeve të ndryshme;
 - përshtatin në kohë e mënyrë gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë;
 - përdorin drejt në të gjitha rastet shenjat e pikësimit,
 - formulojnë **shumë mirë** mendimet, ndjesitë dhe opinionet e veta rreth tekstit.
 - **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Nxënësit **kanë mundur** të:
 - argumentojnë qëndrimin e tyre kundrejt sjelljes dhe gjendjes së një personazhi;
 - veçojnë tipare të stilit dhe interpretojnë sesi ndikojnë ato tek lexuesi.
 - Sipas të dhënave të Grafikut Gj-L-10, **0.23%** e nxënësve janë vlerësuar me **57 pikë** dhe **0.05%** e nxënësve janë vlerësuar me **59 pikë**.
Ky grup nxënësish kanë EDHE arritje të tjera, sipas kompetencave.
 - **Kompetenca:** *Të lexuarit e teksteve të ndryshme.*
Nxënësit:
 - interpretojnë dhe integrojnë informacionet e marra nga teksti me burime të tjera të informacionit;
 - bëjnë përgjithësime në nivel kritik;
 - analizojnë sesi stili i autorit ndikon tek lexuesi, përmes zgjedhjes së fjalëve.
 - **Kompetenca:** *Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.*
Nxënësit:
 - kanë stil origjinal në punën me shkrim;
 - prezantojnë një formë të lartë të organizimit dhe strukturës së fjalive, paragrafëve dhe punimit të esesë në tërësi.
 - **Kompetenca:** *Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkimore dhe të pikësimit.*
Nxënësit **kanë aftësi shumë të mira** të:

- formojnë fjali të llojeve të ndryshme duke përdorur drejt rregullat e koherencës dhe kohezionit.
- **Kompetenca:** *Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.*
Nxënësit kanë mundur të:
 - komentojnë fragmente të tekstit, duke e zbërthyer atë nga pikëpamja përmbajtësore dhe formale;
 - interpretojnë aspekte të ndryshme të fragmentit, duke shprehur drejt opinionin e tyre personal dhe duke e mbështetur atë me argumente;
 - analizojnë funksionet artistike të zgjedhjeve stilistike që bën autori në vepër.

➤ **Shkëlqyeshëm (60 pikë)**

- Në përfundim, sipas të dhënave të Grafikut Gj-L-10, vihet re që numrin e plotë prej **60 pikësh** e kanë mundur ta fitojnë vetëm **0.01%** e nxënësve.

Nxënësit **kanë mundur** të përmbushin EDHE aftësitë e mëposhtme, që lidhen me kompetencat në:

- të lexuarit e teksteve të ndryshme;
- të shkruarit për qëllime personale e funksionale;
- përvetësimin e rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit,
- të analizës, interpretimit dhe vlerësimit të teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit realizojnë **shkëlqyeshëm**:

- komentin e detajuar të fragmentit lidhur me imazhet e përftuara përmes një stili të veçantë e ndikues tek lexuesi;
- interpretimin e **të gjitha** raporteve mes përmbajtjes ideore dhe formale, në krijimin e imazheve në një tekst;
- analizën në thellësi të personazhit, për të zbuluar thelbin e figurës, ndjesitë dhe sjelljet e tij;
- krahasimin në mënyrë të plotë të veprimeve, sjelljeve e ndjesive mes personazheve;
- sigurimin e një stili **thellësisht** origjinal në punën me shkrim;
- vlerësimin në **mënyrë të plotë** të fragmenteve nga pikëpamja përmbajtësore e formale;
- vlerësimin në **mënyrë të plotë** të karaktereve, nga pikëpamja e paraqitjes që u bën atyre autori, përmes teknikave të përshkrimit, të paraqitjes së veprimeve, sjelljeve, të folurit apo ndjesive që i përshkojnë ata (karakteret).

2) Arritjet e nxënësve në Gjuhë shqipe dhe Letërsi - statistika krahasuese.

Tabela Gj-L-11 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel ZVAP.

Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është 36.84 pikë, nota mesatare vjetore në nivel kombëtar është 7.27, ndërsa nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar është 7.46.

Të dhënat e Tabelës Gj-L-11 tregojnë se:

- 20 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Durrës, Vlorë-Himarë, Tiranë, Shkodër, Shijak, Korçë-Pustec, Has, Lushnje, Finiq-Dropull, Kurbin etj.
- 11 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga intervali **35** pikë deri në **36.79** pikë nga nxënësit e tyre **relativisht nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar si ZVAP: Lezhë, Pogradec, Fier, Devoll, Berat, etj.
- 32 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar si ZVAP: Klos, Skrapar, Malësi e Madhe, Bulqizë, Patos, Belsh, etj.

Tabela Gj-L-12 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore në nivel ZVAP, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferenca (NM-NV).

Të dhënat e Tabelës Gj-L-12 tregojnë se:

- 15 ZVAP kanë arritje në provimin e Maturës Shtetërore më të ulta se arritjet vjetore. ZVAP Peqin ka arritje mesatare të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore me **(-0.45)** njësi note krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Në vazhdim, përmendim ZVAP Peqin, Fier, Kolonjë, Kuçovë, Patos, Vau Dejës, Përrenjas, etj.
- 37 ZVAP kanë arritje në provimin e Maturës Shtetërore më të larta se arritjet vjetore. ZVAP Shijak ka arritje mesatare të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore me **(0.79)** njësi note krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Në vazhdim, përmendim ZVAP Elbasan, Durrës, Korçë-Pustec, Kukës, Selenicë, Tropojë, Vlorë-Himarë etj.

Tabela Gj-L-13 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Nga Tabela Gj-L-13 shihet se:

- nivelet më të ulëta të arritjeve mesatare në provimin e Maturës Shtetërore 2022 i përkasin nxënësve të gjimnazit më kohë të shkurtuar.
- 19 ZVAP kanë notë mesatare mature më të lartë se nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar, si: ZVAP Tiranë, Vlorë - Himarë, Finiq-Dropull, Durrës, Kurbin, Korçë-Pustec, Klos, etj.

Tabela Gj-L-14 (e pasqyruar në fund të raportit) paraqet informacion mbi notën mesatare vjetore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.


Ashtu si për notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, edhe për notën mesatare vjetore, nxënësit e gjimnazit me kohë të shkurtuar kanë përgjithësisht arritje më të ulëta, krahasuar me nxënësit e shkollave të profileve të tjera. 16 ZVAP kanë notë mesatare vjetore më të lartë se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar, si: ZVAP Tiranë, Berat, Finiq-Dropull, Has, Kolonjë, Lushnje, Peqin, Vlorë - Himarë etj.

II. Lënda: Matematikë


1) Arritjet e Nxënësve

Grafikët e paraqitur në figurën e mëposhtme japin një informacion krahasues në nivel ZVAP të arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore 2022 dhe arritjeve Vjetore 2021-2022 për lëndën e Matematikës. Grafikët e dhënë tregojnë përqindjet e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”.

Grafiku M-1



Grafiku M-2



Niveli mesatar është marrë kufiri mes notës 7 e 8. Në arritjet e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-nën nivelin mesatar”, është **64.92%**, kundrejt **69.29%** në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në

intervalin “mesatar - mbi nivelin mesatar”, është **35.08%** për arritjet në provimin e Maturës Shtetërore, kundrejt **30.71%** në arritjet vjetore.

Tabela M-1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj** dhe sipas **sistemit publik e privat të arsimit**.

Tabela M-1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	35.41	13.03	7.23	1.64	6.53	1.56
	Meshkuj	30.24	12.15	6.57	1.56	6.79	1.67
	Total	32.87	12.87	6.91	1.63	6.74	1.65
Qytet	Femra	36.68	13.13	7.39	1.65	7.26	1.65
	Meshkuj	31.09	12.41	6.68	1.59	6.33	1.56
	Total	33.87	13.07	7.03	1.66	6.79	1.67
Fshat	Femra	31.23	11.77	6.71	1.51	7.01	1.54
	Meshkuj	26.71	10.25	6.12	1.33	5.93	1.36
	Total	29.21	11.34	6.44	1.46	6.53	1.56
Publik total	Femra	34.16	12.81	7.08	1.62	7.00	1.58
	Meshkuj	28.71	11.43	6.38	1.47	6.02	1.40
	Total	31.49	12.45	6.73	1.59	6.52	1.57
Qytet	Femra	35.43	13.04	7.23	1.64	7.02	1.60
	Meshkuj	29.44	11.77	6.47	1.51	6.07	1.43
	Total	32.41	12.77	6.85	1.63	6.54	1.59
Fshat	Femra	30.56	11.40	6.62	1.47	6.93	1.51
	Meshkuj	26.10	9.68	6.04	1.27	5.85	1.28
	Total	28.56	10.89	6.36	1.41	6.45	1.51
Privat total	Femra	42.77	11.82	8.16	1.44	8.39	1.43
	Meshkuj	39.40	12.29	7.74	1.53	7.68	1.53
	Total	41.13	12.17	7.96	1.50	8.04	1.52
Qytet	Femra	42.58	11.89	8.13	1.45	8.37	1.43
	Meshkuj	39.23	12.29	7.72	1.53	7.66	1.54
	Total	40.93	12.20	7.93	1.51	8.02	1.53
Fshat	Femra	45.16	10.69	8.45	1.28	8.57	1.38
	Meshkuj	42.58	11.78	8.14	1.45	8.15	1.37
	Total	44.14	11.18	8.33	1.36	8.41	1.39

i. Në nivel kombëtar

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Matematikës është **32.87 pikë**, me shmangie mesatare **12.87**
- Vihet një ndryshim domethënës mes pikëve mesatare të mara nga vajzat dhe pikëve mesatare të mara nga djemtë me një vlerë prej **4.52** pikë mesatare. Ky tregues është më i theksuar në fshat se sa në qytet, me një vlerë prej **0.71**.
- **nota mesatare e Maturës Shtetërore është 6.91** me shmangie mesatare **1.63**
- **nota mesatare vjetore është 6.74** me shmangie mesatare prej **1.65**

Pra, në nivel kombëtar nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të Maturës Shtetërore, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.17 njësi note.

Rezultatet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore janë pak më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve, por jo me një marzh rritjeje të dukshme, parametër ky që shpreh qëndrueshmëri në rezultatet e nxënësve.

Nëse shikojmë të dhënat për sistemin privat, shihet se rezultatet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore janë më të ulëta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve, ku arritjet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore janë relativisht më të ulëta kundrejt arritjeve vjetore, respektivisht me **0.08** njësi note. Ky pohim qëndron edhe për kategorinë fshat dhe qytet të sistemit privat.

ii. Arritjet sipas urbanizimit, qytet/fshat

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas kategorive të urbanizimit fshat/qytet, të paraqitura në tabelën M-1, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat.
- mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë rreth **4.66** pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- e njëjta situatë rezulton për sistemin publik për kategoritë fshat/qytet.

iii. Arritjet sipas gjinisë

Të dhënat e Tabelës M-1 tregojnë se, në provimin e Maturës Shtetërore, arritjet mesatare të vajzave janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, për nivelin kombëtar tregon se:

- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **5.17** pikë mbi nivelin e pikëve mesatare të fituara nga djemtë.

- rezultatet e vajzave në provimin e Maturës Shtetërore janë **0.7** njësi note më e lartë, kundrejt rezultateve vjetore (në nivel kombëtar: **7.23** nota mesatare e Maturës Shtetërore; **6.53** nota mesatare vjetore).
- ndërsa për djemtë rezultatet në provimin e Maturës Shtetërore janë **0.22** njësi note më e ulët, kundrejt rezultateve vjetore të tyre (në nivel kombëtar: **6.57** nota mesatare e Maturës Shtetërore 6.79 nota mesatare vjetore).

iv. Arritjet sipas sistemit publik/privat të arsimit.

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas sistemit publik/privat të arsimit, të paraqitura në tabelën M-1, rezulton se:

- në sistemin privat, arritjet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore janë më të ulëta krahasuar me arritjet e vjetore të tyre, përkatësisht me **0.08** njësi note.
- në sistemin publik, arritjet e mesatares në provimin e Maturës Shtetërore, për kategorinë qytet, janë më të larta, referuar arritjeve të nxënësve për kategorinë fshat. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit, në sistemin publik, është **32.41** pikë, kundrejt **28.56** pikë të nxënësve të fshatit.
- mesatarja e pikëve të nxënësve në qytet, në sistemin privat, është **40.93** pikë, kundrejt **44.14** pikë të nxënësve në fshat. Për nxënësit e qytetit, rezultatet e vajzave, në notën vjetore janë **0.13** njësi notë më e ulët kundrejt rezultateve të Maturës Shtetërore (**7.39** nota mesatare e Maturës Shtetërore; **7.26** nota mesatare vjetore). Ndërsa, për djemtë, në notën vjetore janë **0.35** njësi notë më e ulët kundrejt rezultateve të Maturës Shtetërore (**6.68** nota mesatare e Maturës Shtetërore; **6.33** nota mesatare vjetore).

Nga të dhënat e Tabelës M-1, rezulton se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të Maturës Shtetërore dhe atë vjetore. Diferenca prej **9.64** pikësh e mesatares së pikëve mes sistemit privat me atë publik, tregon se, edhe për arritjet në lëndën e Matematikës, ka diferenca të mëdha mes dy sistemeve arsimore që ekzistojnë në vendin tonë.

v. Qëndrueshmëria e arritjeve

Analiza e qëndrueshmërisë së arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore kundrejt arritjeve vjetore, tregon se:

- për lëndën e matematikës, nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të qëndrueshme krahasuar me nxënësit e sistemit publik.
- gjithashtu, edhe për sistemin publik, arritjet e nxënësve të fshatit janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet e nxënësve të qytetit.

Tabela M-2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas profilit të shkollës së ndjekur, si dhe sipas llojit të shkollës publik/privat.

Nxënësit me arritjet më të larta për lëndën e Matematikës janë nxënësit që ndjekin shkollat e profilit gjimnaz, kjo për nivelin kombëtar, po ashtu edhe për sistemin publik. Për sistemin privat të edukimit nxënësit më të mirë janë nxënësit e shkollave gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh. Ndërsa, nxënësit me arritjet më të ulëta, në nivel kombëtar, janë nxënësit që ndjekin gjimnazin në sistemin me kohë të shkurtuar.

Tabela M-2

Lloji i shkollës	Profili i shkollës	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
TOTAL	Gjimnaz	34.54	13.14	7.12	1.66	6.96	1.68
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	31.68	12.02	6.76	1.52	6.93	1.74
	Artistike; Koreografike, Sportive	27.37	7.19	6.23	0.97	5.89	1.02
	Teknike profesionale	25.96	8.94	6.03	1.18	5.75	1.08
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	17.58	5.85	5.39	0.88	5.43	0.61
PUBLIK	Gjimnaz	33.20	12.90	6.95	1.64	6.73	1.61
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	31.48	11.96	6.73	1.52	6.92	1.73
	Artistike; Koreografike, Sportive	27.37	7.19	6.23	0.97	5.89	1.02
	Teknike profesionale	24.66	7.55	5.86	1.01	5.62	0.93
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	23.25	5.65	5.67	0.78	5.43	0.61
	Gjimnaz	41.28	12.26	7.97	1.51	8.13	1.49


PRIVAT	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	45.80	7.33	8.59	0.89	7.77	1.74
	Artistike; Koreografike, Sportive	-	-	-	-	-	-
	Teknike profesionale	39.24	11.01	7.74	1.38	7.01	1.52
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	-	-	-	-	-	-

Tabela M-3 dhe Tabela M-4, si dhe Grafiku M-3 e Grafiku M-4 japin shpërndarjen (në përqindje) të notave të Maturës Shtetërore dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Tabela M-3

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	1.57%	13.07%	17.31%	15.09%	11.59%	10.55%	10.60%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.06%	0.38%	0.69%	0.61%	0.23%	0.17%	0.24%
3	Artistike, Koreografike, Sportive	0.04%	0.27%	0.51%	0.51%	0.08%	0.02%	0.01%
4	Teknike profesionale	0.52%	3.72%	5.00%	2.29%	0.87%	0.47%	0.21%
Në nivel kombëtar (dita)		2.20%	17.45%	23.51%	18.51%	12.78%	11.21%	11.06%
5	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	0.14%	1.14%	1.38%	0.59%	0.03%	0.00%	0.00%
Në nivel kombëtar		2.34%	18.59%	24.89%	19.10%	12.81%	11.21%	11.06%

Grafiku M-3



Shpërndarja e notave (në përqindje) të provimit të Maturës Shtetërore për lëndën e Matematikës.

Në provimin e Maturës Shtetërore, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **97.67%**.
- nota mbizotëruese është **nota 6** dhe **nota 7** me, përkatësisht, **24.89%** dhe **19.10%**.
- **notat 6, 7 dhe 8** kanë një përqindje, shuma e të cilave shkon rreth **56.80%** të nxënësve.
- ndërsa përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** shkon në **11.06 %**.


Në shpërndarjen e notave vjetore të paraqitura në Tabelën M-4, rezulton se nota mbizotëruese është 5 me **32.18%** të totalit të nxënësve, gjë që tregon se arritjet e nxënësve në procesin mësimor në lëndën e Matematikës kanë qenë relativisht të ulëta. Po kështu, tregon se notat 5, 6 dhe 7 kanë një përqindje shuma e të cilave shkon rreth **69.25%** të totalit të nxënësve.

Të dhënat nga Tabela M-4 tregojnë se përqindjet e nxënësve të vlerësuar me nota 9 dhe 10 gjatë procesit mësimor vjetor nuk i kalojnë vlerat prej **19.34%**. Vihet re përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10, është më e madhe kundrejt atyre të vlerësuar me notën 9.

Tabela M-4

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave Vjetore (në %)						
		Pa notë nga shkolla	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.02%	21.72%	16.67%	12.86%	10.39%	8.26%	9.88%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.00%	0.64%	0.62%	0.31%	0.23%	0.22%	0.36%
3	Artistike, Koreografike, Sportive	0.00%	0.69%	0.45%	0.17%	0.08%	0.04%	0.01%
4	Teknike profesionale	0.01%	7.12%	3.47%	1.31%	0.64%	0.32%	0.23%
Në nivel kombëtar (dita)		0.03%	30.17%	21.21%	14.65%	11.34%	8.84%	10.48%
5	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	0.00%	2.01%	1.04%	0.17%	0.04%	0.02%	0.00%
Në nivel kombëtar		0.03%	32.18%	22.25%	14.82%	11.38%	8.86%	10.48%

Grafiku M-4



Shpërndarja e notave (në përqindje) vjetore për lëndën e Matematikës.

Shpërndarja e Notave Vjetore, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **98.16%**.
- nota mbizotëruese është **nota 5** dhe **nota 6** me, përkatësisht, **32.18%** dhe **22.25%**.
- ndërsa përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** shkon në **10.48%**.

Në **Tabelën M-5, Tabelën M-6, Tabelën M-7 dhe Tabelën M-8**, si dhe në **Grafikët përkatës**, janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike përqindjet e notave në nivel kombëtar sipas urbanizimit fshat/qytet, dhe gjinisë femra/meshkuj për provimin e Maturës Shtetërore 2022 dhe arritjet Vjetore 2022, për lëndën e Matematikës.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

MATEMATIKË

**Matura Shtetërore
2022**

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Nota 4	0.63%	1.70%	2.33%
Nota 5	5.39%	13.20%	18.59%
Nota 6	6.29%	18.61%	24.90%
Nota 7	4.14%	14.96%	19.10%
Nota 8	2.30%	10.50%	12.81%
Nota 9	1.54%	9.67%	11.21%
Nota 10	1.14%	9.92%	11.06%


Tabela M-5

Vjetore 2022

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Pa notë	0.02%	0.02%	0.03%
Nota 5	8.04%	24.14%	32.18%
Nota 6	4.54%	17.72%	22.25%
Nota 7	3.34%	11.48%	14.82%
Nota 8	2.27%	9.11%	11.37%
Nota 9	1.68%	7.17%	8.85%
Nota 10	1.56%	8.93%	10.48%


Tabela M-6

Grafiku M-5



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për arritjet e Maturës Shtetërore 2022

Grafiku M-6



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për arritjet Vjetore 2022.

Sipas urbanizimit:

Nga tabela vërejmë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e Maturës Shtetërore, është **11.06 %** e totalit të nxënësve, ku **1.14%** janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, dhe **9.92%** janë nxënës që i përkasin kategorisë qytet.

- Rezultatet e fituara në Maturën Shtetërore 2022, si dhe ato Vjetore 2022, për nxënësit e shkollave të qytetit, janë më të larta, kundrejt nxënësve të fshatit.
- Ka një diferencë të dukshme midis nxënësve në qytet që kanë marrë gjatë vitit notën 10 (8.93%), krahasuar me atë në fshat (1.56%). Kjo diferencë midis dy grupeve është më e madhe në Maturën Shtetërore.
- Përqindja e nxënësve që kanë marr notën 6 dhe 7 në Maturën Shtetërore është më e lartë nëse do ta krahasonim me arritjet vjetore.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

MATEMATIKË

**Matura
Shtetërore 2022**

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Nota 4	0.71%	1.62%	2.33%
Nota 5	7.24%	11.35%	18.59%
Nota 6	10.83%	14.06%	24.90%
Nota 7	10.17%	8.93%	19.10%
Nota 8	7.57%	5.24%	12.81%
Nota 9	7.01%	4.20%	11.21%
Nota 10	7.40%	3.66%	11.06%


Tabela M-7

**Arritjet Vjetore
2022**

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Pa notë	0.01%	0.03%	0.03%
Nota 5	9.01%	23.17%	32.18%
Nota 6	12.29%	9.97%	22.25%
Nota 7	9.12%	5.70%	14.82%
Nota 8	7.45%	3.93%	11.37%
Nota 9	5.93%	2.92%	8.85%
Nota 10	7.14%	3.35%	10.48%


Tabela M-8

Grafiku M-7



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për provimin e Maturës Shtetërore 2022.

Grafiku M-8



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për arritjet vjetore 2022.

Sipas gjinisë:

Të dhënat e Tabelave M-5-6-7-8, si dhe grafikët përkatës tregojnë se:

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e Maturës Shtetërore.
- përqindja e nxënësve që kanë marrë **notën 10** në provimin e Maturës Shtetërore, është **11.06%** e totalit të nxënësve, ku **7.40%** janë vajza dhe **3.66%** janë djem.
- numri i nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore është më i lartë, krahasuar me numrin e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor.

- përqindja e mbetësve në provimin e Maturës Shtetërore për kategorinë “meshkuj” është më e madhe krahasuar me kategorinë “femra”.
- në notat 8, 9 dhe 10 të rezultateve të provimit të Maturës Shtetërore, si dhe në ato vjetore, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë “meshkuj”.
- për kategorinë “vajza”, kemi rritje prej **3.6%** të numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore (**7.40%**), kundrejt vlerësimit vjetor (**7.14%**). Për kategorinë “djem”, , kemi rritje prej **9.3%** të numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore (**3.66%**), kundrejt vlerësimit vjetor (**3.35%**).
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 4 në provimin e Maturës Shtetërore (**2.33%**) tregon se pjesa më e madhe i takon nxënësve të fshatit (**0.63%**), kundrejt nxënësve të qytetit (**1.70%**) (kjo referuar përqindjes që zënë nxënësit e fshatit kundrejt totalit - rreth 21% e totalit të nxënësve).
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me **notën 10** gjatë procesit mësimor vjetor është **10.48%**, prej të cilëve **7.14%** janë vajza, dhe **3.35%** djem.

Gjetjet e mësipërme tregojnë se, nëse krahasojmë arritjet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore 2022 me arritjet Vjetore 2022, arrijmë në përfundimin se arritjet e nxënësve për lëndën e Matematikës karakterizohen nga një “paqëndrueshmëri relative”.

Tabela M-9 jep të dhëna mbi shkallën e **paqëndrueshmërisë** së rezultateve Vjetore 2022 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2021-2022), të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës Shtetërore 2022, për lëndën e Matematikës.

Tabela M-9

		Notat e Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
pa notë	0.03%	0.01%	0.01%	0.01%	0.01%	0.00%	0.00%	0.00%
5	32.18%	1.71%	10.96%	11.53%	5.43%	1.76%	0.64%	0.16%
6	22.25%	0.46%	4.75%	7.13%	5.19%	2.75%	1.44%	0.52%
7	14.82%	0.11%	1.89%	3.62%	3.97%	2.57%	1.85%	0.81%
8	11.37%	0.04%	0.73%	1.81%	2.59%	2.50%	2.32%	1.39%
9	8.85%	0.01%	0.20%	0.62%	1.43%	2.09%	2.43%	2.08%
10	10.48%	0.00%	0.05%	0.18%	0.48%	1.15%	2.53%	6.10%
Gjithsej	100%	2.33%	18.59%	24.90%	19.10%	12.81%	11.21%	11.06%

Tabela M-9 lexohet si më poshtë:

- ❖ Nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve, vetëm 10.48% e tyre kanë marrë vlerësimin 10 gjatë vitit shkollor në lëndën e Matematikës, ndërkohë që përqindja e nxënësve që kanë marrë vlerësimin 10 edhe në provimin e Maturës Shtetërore është 6.10% e totalit të nxënësve.
- ❖ Nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në provimin e Maturës Shtetërore, duhet të rezultonin po 10.48% nota 10 në nivel kombëtar. Por, përsëri, nga rreshti i parafundit i tabelës, shihet se kemi edhe praninë e nxënësve me notë 5 (0.05%); notë 6 (0.18%); notë 7 (0.48%); notë 8 (1.15%); notë 9 (2.53%). Këto shifra tregojnë se nxënësit e vlerësuar me notë 10 gjatë vitit shkollor, në provimin e Maturës Shtetërore janë vlerësuar edhe me notën 5, 6, 7, 8. Shqetësuese është dukuria që një nxënës i vlerësuar me 10 gjatë procesit mësimor në provimin e Maturës Shtetërore është ulur në vlerësim me 3 deri në 4 nota.


Nga rreshtat e parë të Tabelës M-9, të dhënat tregojnë se një përqindje e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 6 e 7, në provimin e Maturës Shtetërore kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8, 9 dhe 10.

Nga **33.18%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, vetëm **10.96%** kanë mbajtur po atë notë në provimin e Maturës Shtetërore. Ndërsa, prej tyre, ka nxënës që në provimin e Maturës Shtetërore kanë marrë edhe vlerësime me mbi 2, 3 apo më shumë nota ose që kanë zbritur në vlerësim me 1 notë. (Kategoria “pa notë vjetore” tregon se në databazën e QSHA për ta nuk ka notë vjetore, ose kjo lëndë nuk është lëndë mësimore në maturë, shih: Metodologjia).

2) Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës.

Grafiku M-9 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e Maturës Shtetërore 2022 në lëndën e Matematikës. Shihet se rreth **35.80%** e nxënësve janë vlerësuar me pikë që ndodhen në intervalin 0-25 pikë, dhe më tej grafiku vazhdon në rënie.


Grafiku M-9



Shpërndarja e pikëve të fituara në provimin e Matematikës në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku M-9 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara në provimin e Matematikës në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku M-10



Shpërndarja kumulative të pikëve të fituara në provimin e Matematikës në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku M-9 tregon se:

- rreth **0.77%** e nxënësve kanë marrë maksimalen e pikëve të testit **60 pikë**.
- **4.06%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 15 pikë**.
- **35.80%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 25 pikë**.
- **51.35%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 30 pikë**.
- **79.16%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 45 pikë**.
- **86.17%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0 – 50 pikë**.

Sikurse vihet re nga grafiku M-9, rezultatet e arritjeve të nxënësve lidhen me 3 nivelet e arritjes (përkatësisht: niveli i parë notat 5 - 6; niveli i dytë notat 7 - 8 dhe niveli i tretë notat 9-10).

Konkretisht rezulton se:

- **0.77%** e nxënësve kanë arritur të marrin pikët maksimale 60 pikë.
- **51.35%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 30 pikë.
- **4.06%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 15 pikë.
- **1.11%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 11 pikë dhe kanë rezultuar jo kalues.

Po të bëjmë një interpretim të rezultateve të arritjes, nisur nga grafiku M-9, arrijmë në konkluzionet si më poshtë:

- **Dobët** (përfshihen nxënësit që janë vlerësuar me notën **4** në testin e MSH).

Rezulton se **1.11 %** e nxënësve janë vlerësuar në këtë nivel (ata kanë mundur të marrin nga 0-11 pikë). Kjo do të thotë që ky grup nxënësish nuk e kanë kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.

- **Mjaftueshëm** (përfshihen nxënësit që arrijnë nivelin e parë dhe që kanë fituar notën **5** dhe **6**)

Grafiku M-10 tregon që **4.06%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 15 pikë.

Po të specifikojmë (sipas kompetencave të lëndës), vërejmë se ky grup nxënësish kanë fituar arritjet e mëposhtme:

Kompetenca: Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik.

Nxënësit kanë arritur të fitojnë aftësi të tilla:

- përdorin simbolet përkatëse, diagramin e Venit, për të paraqitur bashkësitë dhe marrëdhënien ndërmjet tyre;
- njehsojnë rrënjët me tregues numër natyror dhe fuqi me eksponent thyesor;
- thjeshtojnë shprehje që përmbajnë rrënjë dhe zhduk rrënjën nga emëruesi;
- kthejnë numrat dhjetorë të fundmë në thyesa dhe anasjellas;
- përdorin vetitë e logaritmeve;
- shprehin si raport ose thyesë një marrëdhënie shumëfishiteti ndërmjet dy sasive;
- përdorin konceptet e sinusit, kosinusit, tangjentit dhe kotangjentit dhe formulat trigonometrike bazë në trekëndëshin kënddrejtë;
- paraqesin në mënyrë algjebrike mbledhjen e vektorëve, si dhe shumëzimin e vektorit me një numër;
- gjejnë koordinatat e mesit të segmentit;
- zgjidhin në mënyrë algjebrike ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën përkatëse;
- gjejnë ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika;
- përdorin trajtën $y = kx + t$ për të identifikuar drejtëzat paralele dhe pingule;
- njehsojnë largesën ndërmjet dy pikave.

Ndërkaq **35.80%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 25 pikë. Ky grup nxënësish, kanë siguruar përveç arritjeve të mësipërme, edhe rezultatet e mëposhtme sipas kompetencave përkatëse, si të:

- përdorin në zbatime prerjen dhe bashkimin e dy bashkësive;
- zbatojnë paraqitjen në shtyllë të vektorit, me anë të koordinatave dhe të përdorin vektorët me dy koordinata për zgjidhje të situatave të ndryshme;
- përdorin ekuacionin e drejtëzës, përfshirë trajtat $y - y_1 = k(x - x_1)$;
- njehsojnë vëllimin e kuboideve, prizmit të drejtë, cilindrit;
- provojnë dhe zbatojnë teoremat e rrethit që i referohen këndeve, rrezes, tangjentes, kordave dhe i përdorin ato për të zgjidhur situata problemore;
- kuptojnë dhe përdorin këndet korresponduese që formohen nga drejtëza paralele;
- zëvendësojnë vlerat numerike në formula dhe shprehje;
- njehsojnë integralin e caktuar (Formula e Njuton –Leibnic).

- **Mirë** (përfshihen nxënësit që kanë arritur nivelin e dytë dhe që kanë fituar notën 7 dhe 8)

Sipas pikëve të paraqitura në Grafikun M-10, rezulton se **51.35%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 30 pikë, të cilët, në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

Kompetenca: Zgjidhja e situatës problemore.

Nxënësit kanë mundur të fitojnë aftësi të tilla, si të :

- zgjidhin situata problemore me përqindje, me rritje dhe me ulje të vlerës në përqindje.
- zgjidhin situata problemore, ku madhësi të ndryshme kanë marrëdhënien e përpjesëtimit të drejtë apo të zhdrejtë, apo jepen raporte konkrete mes tyre.
- përdor radhën e veprimeve algjebrike duke përfshirë kllapat, fuqitë rrënjët, të kundërtin, të anasjelltin.
- zgjidhin situata problemore duke zbatuar vetitë e fuqive, logaritmeve.
- përdorin rregullat e fuqive me eksponentë racionalë dhe zgjidhin ekuacione të trajtës: jepet funksioni $f(x) = \sqrt[3]{x}$, gjeni vlerën e $f'(4)$;
- përdorin simbolet përkatëse në lidhje me marrëdhëniet mes dy ose më shumë bashkësive.
- përshkruajnë veti dhe ndërtojnë figurën e konit rrethor të drejtë, njehsojnë përmes formulave përkatëse elementë gjeometrikë të tij si p.sh: përfutjesja e konit
- kryejnë veprime me vektorë të dhënë në koordinata
- zgjidhin trekëndëshin kënddrejtë përmes marrëdhënieve trigonometrike në të,
- zgjidhin trekëndëshin çfarëdo përmes teoremave të sinusit apo kosinusit.
- zëvendësojnë vlerat numerike në formula dhe shprehje;
- faktorizojnë plotësisht një polinom te rendit të tretë
- analizojnë dallorin e një polinomi të fuqisë së dytë duke përfshirë kushtet për rrënjët dhe rrënjën e dyfishtë; zgjidhin në mënyrë algjebrike ekuacione të fuqisë së dytë, duke përdorur formulën kuadratike ose përmes faktorizimit;
- shkruajnë ekuacionin e drejtëzës që kalon nëpër dy pika,
- zbaton kushtin e pingultisë (paralelizmit) të dy drejtëzave
- përdorin derivatin e funksionit $f(x)$ si koeficient këndor të tangjentes ndaj grafikut të funksionit $y = f(x)$ në një pikë çfarëdo (x,y) të grafikut të funksionit;
- studiojnë monotoninë e funksionit përmes shenjës së derivatit të parë të tij
- zbatojnë kuptimin gjeometrik të integralit të caktuar në njehsimin e syprinës së një zone plane të dhënë duke caktuar kufijtë e tij.
- njehsojnë probabilitetin e ngjarjeve të kombinuara dhe të papajtueshme, e ngjarjes me kusht;
- lexojnë dhe plotësojnë tabelën e shpërndarjes së probabiliteteve të një prove të dhënë.
- zbatojnë kuptimin e mesatares aritmetike si tregues statistikor për një shpërndarje të dhënash.

Ndërkaq **79.16%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 45 pikë, dhe ky grup nxënësish kanë edhe arritje të tjera të mëposhtme, sipas kompetencave.

Kompetenca: Arsyetimi dhe vërtetimi matematik.

Nxënësit kanë mundur të fitojnë aftësi të tilla, si të:

- shndërrojnë në mënyrë algjebrike polinomet duke përfshirë zbërthimin e kllapave, reduktimin e kufizave;
- përdorin konceptin dhe fjalorin e duhur për numrat e thjeshtë, faktorët (pjesëtuesit), si dhe teoremën e zbërthimit të numrave në faktorë të thjeshtë;
- përdorin funksionet kuadratike dhe grafikët e tyre në zgjidhje të situatave reale;
- gjejnë dhe interpretojnë rrënjët e ekuacionit kuadratik;
- thjeshtojnë një shprehje logaritmike në sajë të vetive përkatëse
- njehsojnë mesataren aritmetike të një grupi të dhënash;
- përcaktojnë ekstremumet e funksionit me anë të derivatit; përcakton intervalet e monotonisë së funksionit.
- argumenton qartazi kuptimet e derivatit të funksionit (analitik, gjeometrik) p.sh: shfrytëzimi i tangjencës së një drejtëze me grafikun e një funksioni të dhënë në të cilin mungon një parametër.
- provon sipas një rasti të caktuar ngjashmërinë e dy trekëndëshave në një situatë problemore komplekse, duke argumentuar mbi kushtet e dhëna.
- njohin dhe përdorin konceptin e integritetit si proces i anasjelltë i derivimit (Teorema themelore e njehsimit diferencial dhe integral);
- interpretojnë, analizojnë dhe krahasojnë shpërndarjen e të dhënave rreth një tipari cilësor në një popullatë të caktuar, p.sh: nxënësit me notën 10 në disa lëndë të ndryshme.

➤ **Shumë mirë** (përfshin nivelin e tretë të arritjeve, që përkon me notat **9** dhe **10**).

Sipas pikëve të paraqitura në Grafikun M-10, rezulton se **86.17%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 50 pikë, të cilët në përputhje me kompetencat e arritjeve zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

Kompetenca: Modelimi matematik

Nxënësit arrijnë të:

- zbatojnë teoremën e sinusit dhe teoremën e kosinusit në trekëndëshin e çfarëdoshëm për të gjetur gjatësi, kënde, syprinë;
- interpretojnë veprimin e njëpasnjëshëm të dy funksioneve si funksion i përbërë;
- interpretojnë raportet /përqindjet që zënë grupe të ndryshme elementësh në të tërën
- zbatojnë vetinë që shuma e probabiliteteve e të gjitha ngjarjeve elementare është një;
- përdorin integralin e caktuar për të gjetur syprinën nën një vijë;
- njehsojnë probabilitetin e ngjarjeve të kombinuara të varura dhe të pavarura,

➤ **Shkëlqyeshëm** (60 pikë)

Në përfundim, vihet re që **0.77%** e nxënësve janë vlerësuar me 60 pikë. Kjo lidhet me përmbushjen e të gjitha kompetencave të mësipërme dhe që kanë edhe arritje të tjera të mëposhtme, sipas kompetencave.

- Ata janë të aftë të zbatojnë në mënyrë krijuese në situata të reja dhe të panjohura konceptet dhe njohuritë e marra në matematikë.
- Nxënësit e këtij niveli interpretojnë situata në jetën reale, e modelojnë në gjuhën matematike dhe gjejnë zgjidhje matematike.
- Ata përdorin saktë silogjizmin matematik në argumentin për zgjidhjen e situatave problemore.

3) Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese.

Tabela M-10 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel ZVAP.

Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është **32.87** pikë, nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar është **6.91**, ndërsa nota mesatare vjetore në nivel kombëtar është **6.74**.

Të dhënat e Tabelës M-10 tregojnë se:

- 20 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Tiranë, Has, Peqin, Kurbin, Kavajë, Kukës, Gramsh, Tropojë, Rrogozhinë etj.
- 32 ZVAP kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Dibër, Shijak, Devoll, Patos, Fier, Berat, Lezhë, Elbasan. etj.

Tabela M-11 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore për lëndën e Matematikës, në nivel ZVAP, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferencën (NM – NV).

Të dhënat e tabelës M-11 tregojnë se:

- 28 ZVAP kanë arritje të Maturës Shtetërore më të larta se arritjet vjetore, si ZVAP: Has, Kavajë, Gramsh, Kukës, Kurbin, Tropojë, Rrogozhinë, Peqin, Krujë, Tiranë.
- 1 ZVAP (Mirditë) kanë arritje të Maturës Shtetërore të barabartë me arritjet vjetore
- 23 ZVAP e tjera kanë arritje mesatare të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore më të ulëta, krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Diferenca më e madhe mes dy treguesve arrin vlerën (2.09) në ZVAP Has.

Tabela M-12 (e pasqyruar në fund të raportit) paraqet informacion mbi notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz

gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Nivelet më të ulëta të arritjeve mesatare në provimin e Maturës Shtetërore u përkasin nxënësve të gjimnazit me kohë të shkurtuar. 24 ZVAP kanë notë mesatare në maturë më të lartë se nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar, si ZVAP: Has, Peqin, Kurbin, Kavajë, Kukës, Gramsh, Tropojë, Rrogozhinë, Krujë etj.

1 ZVAP (Mat) e ka notën mesatare të barabartë me notën mesatare të Maturës Shtetërore në nivel kombëtar.

32 ZVAP kanë notë mesatare në maturë më të ulët se nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar, si ZVAP: Shijak, Librazhd, Mallakastër, Vlorë-Himarë, Bulqizë, Devoll, Pogradec, etj.

Tabela M-13 (e pasqyruar në fund të raportit) paraqet informacion mbi notën mesatare vjetore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Ashtu si për notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, edhe për notën mesatare vjetore, nxënësit e gjimnazit me kohë të shkurtuar kanë përgjithësisht arritje më të ulëta krahasuar me nxënësit e shkollave të profileve të tjera. 22 ZVAP kanë notë mesatare vjetore më të lartë se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar, si ZVAP: Has, Peqin, Kurbin, Kolonjë, Tiranë, Berat, etj.


30 ZVAP kanë notë mesatare vjetore më të ulët se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar, si ZVAP: Kavajë, Bulqizë, Lezhë, Krujë, Tropojë etj.

III. Lënda: Gjuhë e Huaj


1) Arritjet e Nxënësve

Figura e mëposhtme paraqet arritjet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore dhe arritjet vjetore në lëndën e Gjuhës së huaj 2022. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar dhe në nivel ZVAP. Në grafik jepet informacion mbi përqindjen e nxënësve, njohuritë e të cilëve janë në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe “mbi nivelin mesatar”. Si nivel mesatar është marrë kufiri mes notës 7 dhe 8.

Grafiku G-1



Grafiku G-2



Në arritjet e provimit të Maturës Shtetërore, në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - nën nivelin mesatar”, është **43.47%** kundrejt **53.45%** në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar - mbi nivelin mesatar”, është **56.53%** për arritjet në provimin e Maturës Shtetërore kundrejt **44.55%** në arritjet vjetore.

Tabela G-1 jep informacion mbi arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës së huaj në nivel kombëtar. Arritjet e nxënësve në këtë lëndë janë paraqitur në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, për **sistemin publik dhe privat të arsimit**.

Tabela G-1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	42.38	12.26	8.11	1.50	7.94	1.67
	Meshkuj	36.57	12.72	7.39	1.59	6.81	1.75
	Total	39.53	12.82	7.75	1.59	7.38	1.80
Qytet	Femra	43.93	12.05	8.29	1.47	8.07	1.66
	Meshkuj	37.69	12.90	7.52	1.61	6.96	1.78
	Total	40.79	12.87	7.91	1.59	7.51	1.81
Fshat	Femra	37.26	11.53	7.49	1.45	7.49	1.63
	Meshkuj	31.97	10.81	6.82	1.38	6.17	1.52
	Total	34.90	11.52	7.19	1.45	6.90	1.71
Publik total	Femra	40.96	12.16	7.94	1.50	7.74	1.66
	Meshkuj	34.88	12.24	7.18	1.54	6.54	1.67
	Total	37.97	12.57	7.56	1.57	7.15	1.77
Qytet	Femra	42.50	12.10	8.12	1.48	7.85	1.66
	Meshkuj	35.90	12.57	7.30	1.58	6.67	1.71
	Total	39.16	12.77	7.71	1.59	7.25	1.79
Fshat	Femra	36.58	11.21	7.41	1.41	7.41	1.61
	Meshkuj	31.23	10.23	6.73	1.31	6.06	1.43
	Total	34.18	11.10	7.10	1.41	6.81	1.67
Privat total	Femra	50.77	9.08	9.10	1.05	9.12	1.13
	Meshkuj	46.74	10.65	8.64	1.27	8.40	1.40
	Total	48.80	10.08	8.87	1.18	8.77	1.32
Qytet	Femra	50.71	9.12	9.09	1.05	9.12	1.14
	Meshkuj	46.53	10.73	8.61	1.28	8.37	1.40
	Total	48.64	10.16	8.85	1.19	8.75	1.33
Fshat	Femra	51.58	8.60	9.19	0.98	9.19	1.02
	Meshkuj	50.72	8.21	9.10	0.93	8.95	1.12
	Total	51.24	8.44	9.15	0.96	9.10	1.07

i. Në nivel kombëtar

- mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Gjuhës së huaj është **39.53** pikë, me shmangie mesatare **12.82**.
- mesatarja e notës së Maturës Shtetërore **7.75**, me shmangie mesatare **1.59**.
- mesatarja e notës vjetore **7.38**, me shmangie mesatare prej **1.80**.

Në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare të Maturës Shtetërore me notën mesatare vjetore, rezulton se ndryshueshmëria është me rreth 0.37 njësi note.

Rritja më e madhe e rezultateve të Maturës Shtetërore kundrejt atyre vjetore i përket sistemit publik të arsimit, kategorisë fshat - meshkuj. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Maturës Shtetërore për kategorinë qytet, të sistemit publik është **39.16** pikë. Gjithashtu, vihet re se, nota mesatare vjetore e kategorisë qytet, të sistemit publik, është më e ulët se nota mesatare vjetore e kategorisë qytet të sistemit privat, me rreth **1.5** njësi note.

ii. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Rezultatet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se:

- ka diferenca mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre të fshatit. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë rreth **4.98** pikë më e lartë, ndaj nxënësve të fshatit, kur ndërkohë, vlerat e shmangies mesatare për pikët e fituara në test për të dyja kategoritë, janë në vlera (**12.87**) me (**11.52**).
- Ekzistenca e diferencës prej **5.89** pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston me rreth **0.72** njësi note të notës mesatare të Maturës Shtetërore mes këtyre dy kategorive.

iii. Arritjet sipas gjinisë

Edhe në provimin e Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës së Huaj:

- vajzat dallohen për arritje mesatare më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve; kjo si për sistemin publik, po ashtu edhe për sistemin privat.
- Por, nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore me arritjet vjetore, në nivel kombëtar, rezulton se, për vajzat diferenca arrin vlerën **0.17** njësi notë, ndërsa për djemtë diferenca arrin vlerën **0.58** njësi notë. Pra djemtë kanë rritje të rezultateve të tyre në maturë kundrejt rezultateve vjetore.

i. Arritjet sipas sistemit publik/privat të arsimit.

Vihet re nga të dhënat se:

- nxënësit e sistemit privat të arsimit kanë rezultate më të larta, krahasuar me nxënësit e sistemit publik, si për arritjet në provimin e Maturës Shtetërore, po ashtu edhe në arritjet vjetore. Totali i pikëve të fituara nga kategoria fshat-femra e sistemit privat përbën vlerën më të lartë të arritur (**51.58** pikë).

ii. Qëndrueshmëria e arritjeve.

Nga të dhënat e **Tabelës G-1**, rezulton se, për të gjitha kategoritë fshat/qytet, femra/meshkuj dhe publik/privat, arritjet mesatare të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore dallojnë pak nga arritjet mesatare vjetore të tyre.

Tabela G-2.1 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas profilit të shkollës së ndjekur, si edhe sipas llojit të shkollës publik/privat, për lëndën e Gjuhës së huaj. Nga të dhënat rezulton se, si për sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat, arritjet mesatare më të larta i përkasin nxënësve që ndjekin shkollat – gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh.

Të dhënat e **Tabelës G-2.2** tregojnë se arritjet më të larta në provimin e Maturës Shtetërore u takojnë nxënësve, të cilët mësojnë gjuhë të huaj Anglisht (B2), Gjermanisht (B1), Italisht (B2).

Të dhënat e **Tabelës G-2.3** tregojnë se arritjet në provimin e Maturës Shtetërore dhe arritjet vjetore për çdo gjuhë të huaj, si dhe sipas profilit të shkollës.

Tabela G-2.1

		Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
Profili i shkollës		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
TOTAL	Gjimnaz	41.43	12.30	7.99	1.51	7.61	1.79
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	40.75	12.80	7.90	1.56	7.85	1.78
	Artistike; Koreografike. Sportive	34.77	11.93	7.17	1.50	7.12	1.52
	Teknike profesionale	31.66	11.69	6.77	1.49	6.38	1.46
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	25.97	8.68	6.03	1.15	5.55	0.80
	Gjimnaz	39.91	12.15	7.81	1.50	7.37	1.77
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	40.66	12.85	7.89	1.57	7.83	1.79
PUBLIK	Artistike; Koreografike. Sportive	34.77	11.93	7.17	1.50	7.12	1.52
	Teknike profesionale	30.33	10.83	6.60	1.39	6.22	1.33
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	25.97	8.68	6.03	1.15	5.55	0.80
	Gjimnaz	49.11	9.91	8.91	1.16	8.85	1.28
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	47.20	6.21	8.76	0.76	9.07	0.64
	Artistike; Koreografike. Sportive	-	-	-	-	-	-
	Teknike profesionale	45.34	11.42	8.47	1.38	7.90	1.46
PRIVAT	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	-	-	-	-	-	-

Tabela G-2.2

Gjuha e Huaj	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
	Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
ANGLISHT (B1)	31.48	11.61	6.75	1.48	6.35	1.46
ANGLISHT (B2)	42.26	12.11	8.09	1.48	7.67	1.79
FRENGJISHT (B1)	21.68	4.83	5.46	0.65	6.12	1.31
FRENGJISHT (B2)	33.57	11.21	7.02	1.42	6.95	1.69
GJERMANISHT (B1)	38.95	10.84	7.74	1.34	7.71	1.57
ITALISHT (B1)	26.62	7.33	6.13	0.99	5.74	1.00
ITALISHT (B2)	36.96	11.97	7.45	1.51	7.60	1.70
SPANJISHT (B1)	28.47	11.60	6.34	1.49	7.44	1.36
TURQISHT (B1)	30.38	13.69	6.58	1.75	8.04	1.59
Total	39.53	12.82	7.75	1.59	7.38	1.80

Tabela G-2.3

Lënda	Profili i shkollës	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës Shtetërore		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Anglisht (B1)	Gjimnaz	29.01	11.82	6.42	1.54	6.77	1.73
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2						
	gjuhësh	-	-	-	-	-	-
	Artistike; Koreografike. Sportive	35.54	11.76	7.27	1.47	7.14	1.54
	Teknike profesionale	32.46	11.73	6.87	1.49	6.43	1.48
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	26.21	9.00	6.06	1.20	5.60	0.83
	Total	31.48	11.61	6.75	1.48	6.35	1.46
Anglisht (B2)	Gjimnaz	42.31	12.07	8.10	1.48	7.68	1.79
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2						
	gjuhësh	41.40	12.76	7.97	1.54	7.36	1.90
	Artistike; Koreografike. Sportive	57.00	0	9.79	0	10.00	0
	Teknike profesionale	30.52	5.63	6.66	0.74	5.29	0.46

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	36.25	12.78	7.57	1.73	7.67	1.79
	Total	18.63	3.42	5.00	0.52	6.15	1.35
Frëngjisht (B1)	Gjimnaz	19.74	2.54	5.18	0.36	6.12	0.63
	Artistike; Koreografike.						
	Sportive	22.35	4.94	5.55	0.67	6.50	1.42
	Teknike profesionale	21.51	4.89	5.46	0.60	5.21	0.36
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	21.68	4.83	5.46	0.65	6.12	1.31
	Total	32.45	10.48	6.88	1.34	6.79	1.60
Frëngjisht (B2)	Gjimnaz	45.54	11.23	8.49	1.33	8.79	1.43
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2						
	gjuhësh	26.03	5.33	6.06	0.72	5.19	0.50
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	33.57	11.21	7.02	1.42	6.95	1.69
	Total	-	-	-	-	-	-
Gjermanisht (B1)	Gjimnaz	38.95	10.84	7.74	1.34	7.71	1.57
	Gjimnaz gjuhësor dhe seksioni dygjuhësh						
		38.95	10.84	7.74	1.34	7.71	1.57
	Total	27.36	11.91	6.18	1.64	6.00	0.95
Italisht (B1)	Gjimnaz	30.09	7.71	6.60	1.01	7.58	1.11
	Artistike; Koreografike.						
	Sportive	26.46	7.10	6.11	0.96	5.66	0.93
	Teknike profesionale	26.62	7.33	6.13	0.99	5.74	1.00
	Total	37.17	11.79	7.48	1.49	7.52	1.73
Italisht (B2)	Gjimnaz	36.16	12.66	7.33	1.58	7.89	1.55
	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2						
	gjuhësh	36.96	11.97	7.45	1.51	7.60	1.70
	Total	30.52	5.63	6.66	0.74	5.29	0.46
Spanjisht (B1)	Gjimnaz gjuhësor dhe	28.47	11.60	6.34	1.49	7.44	1.36

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

	Seksioni 2 gjuhësh						
	Total	28.47	11.60	6.34	1.49	7.44	1.36
Turqisht (B1)	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	30.38	13.69	6.58	1.75	8.04	1.59
	Total	30.38	13.69	6.58	1.75	8.04	1.59


Në provimin e Maturës Shtetërore, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **99.14%**.
- nota mbizotëruese është Nota 10 me 22.05%.
- nga të dhënat rezulton se notat 8, 9 dhe 10 kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth **56.54 %** të totalit të nxënësve.

Tabela G-3.1

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.41%	4.27%	9.43%	15.31%	15.11%	14.97%	20.29%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.01%	0.15%	0.29%	0.53%	0.41%	0.39%	0.60%
3	Artistike. Koreografike. Sportive	0.02%	0.20%	0.31%	0.34%	0.24%	0.20%	0.15%
4	Teknike profesionale	0.31%	2.32%	3.21%	3.47%	1.77%	1.00%	1.01%
Në nivel kombëtar (dita)		0.75%	6.93%	13.23%	19.66%	17.54%	16.54%	22.05%
5	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	0.12%	0.96%	1.14%	0.69%	0.30%	0.06%	0.04%
Në nivel kombëtar		0.86%	7.89%	14.37%	20.34%	17.84%	16.60%	22.10%

Grafiku G-3.1




Shpërndarja e notave (në përqindje) të provimit të Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës së Huaj.

Tabela G-3.2

Nr.	Gjuhët e huaja	Kalueshmëria në provimin e Maturës Shtetërore në %	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
			4	5	6	7	8	9	10
1	ANGLISHT D3 (B1)	97.48%	2.52%	18.37%	24.08%	25.99%	14.02%	7.96%	7.06%
2	ANGLISHT D3 (B2)	94.61%	0.49%	4.59%	10.20%	13.88%	19.21%	19.40%	27.32%
3	FRENGJISHT (B1)	97.69%	2.31%	47.19%	44.55%	4.62%	0.99%	0.33%	
4	FRENGJISHT (B2)	99.47%	0.53%	10.55%	29.73%	25.20%	14.97%	9.70%	9.32%
5	GJERMANISH T (B1)	98.78%	1.22%	2.44%	12.20%	21.95%	26.83%	29.27%	6.10%
6	ITALISHT (B1)	97.76%	2.24%	22.04%	37.38%	29.39%	7.35%	0.96%	0.64%
7	ITALISHT (B2)	99.55%	0.45%	10.96%	17.23%	21.03%	19.69%	19.24%	11.41%
8	SPANJISHT (B1)	78.95%		15.79%	15.79%	26.32%	10.53%	5.26%	5.26%
9	TURQISHT D3 (B1)	91.67%	8.33%	25.00%	16.67%	12.50%	20.83%	8.33%	8.33%

Grafiku G-3.2



shpërndarja e notave të provimit të Maturës Shtetërore sipas lëndëve.

Tabela G-3.2, si dhe **Grafiku G-3.2** japin shpërndarjen e notave (në përqindje) të Maturës Shtetërore për lëndët e Gjuhëve të huaja 2022. Nga të dhënat e mësipërme rezulton që kalueshmërinë më të lartë e kanë arritur nxënësit që kanë dhënë Gjuhën Italiane Gjithashtu, përqindja më e madhe e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore i përket gjuhës së huaj Anglisht (B2). përkatësisht me **27.32%** e pasuar nga Italisht (B2) me **11.41%**

Në vijim, **Tabela G-4.1**, si dhe **Grafiku G-4.1** japin shpërndarjen e notave vjetore (në përqindje) për lëndën e Gjuhës së huaj.


Në nivel kombëtar:

- nota mbizotëruese është Nota 5 me **20.85%**.
- nga të dhënat rezulton se notat 8, 9 dhe 10 kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth **46.54%** të totalit të nxënësve.

Tabela G-4.1

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave Vjetore (në %)						
		Pa notë nga shkolla	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.02%	14.26%	12.95%	11.00%	11.21%	11.79%	18.55%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh	0.00%	0.35%	0.34%	0.31%	0.33%	0.41%	0.65%
3	Artistike. Koreografike. Sportive	0.00%	0.24%	0.36%	0.32%	0.22%	0.15%	0.16%
4	Teknike profesionale	0.01%	4.23%	4.03%	1.87%	1.17%	0.93%	0.86%
Në nivel kombëtar (dita)		0.03%	19.07%	17.67%	13.50%	12.93%	13.27%	20.22%
5	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	0.01%	1.78%	1.14%	0.24%	0.10%	0.03%	0.00%
Në nivel kombëtar		0.04%	20.85%	18.82%	13.74%	13.02%	13.30%	20.22%

Grafiku G-4.1




Shpërndarja e notave (në përqindje) vjetore për lëndën e Gjuhëve të huaja..

Tabela G-4.2, si dhe Grafiku G-4.2 japin shpërndarjen e notave vjetore (në përqindje) për lëndët e Gjuhëve të Huaja. Përqindja më e madhe e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në vlerësimin vjetor i përket Gjuhës Anglisht(B2), përkatësisht me 24.48%.

Tabela G-4.2

Nr.	Gjuhët e huaja	Shpërndarja e Notave Vjetore sipas Lëndëve (në %)						
		Pa notë nga shkolla	5	6	7	8	9	10
1	ANGLISHT (B1)	0.17%	32.60%	31.12%	14.39%	9.16%	6.35%	6.21%
2	ANGLISHT (B2)	0.01%	17.26%	15.68%	13.56%	13.88%	15.12%	24.48%
3	FRENGJISHT (B1)		41.91%	27.39%	13.53%	6.27%	8.25%	2.64%
4	FRENGJISHT (B2)	0.05%	27.33%	21.20%	15.29%	13.05%	11.03%	12.04%
5	GJERMANISHT (B1)		14.63%	12.20%	12.20%	23.17%	26.83%	10.98%
6	ITALISHT (B1)		49.84%	33.23%	8.31%	5.43%	1.60%	1.60%
7	ITALISHT (B2)		14.54%	18.12%	13.42%	18.79%	15.21%	19.91%
8	SPANJISHT (B1)			31.58%	21.05%	26.32%	10.53%	10.53%
9	TURQISHT (B1)		8.33%	12.50%	8.33%	25.00%	29.17%	16.67%

Grafiku G-4.2



Shpërndarja e notave vjetore sipas lëndëve të Gjuhëve të huaja

Të dhëna mbi përqindjet e notave në nivel kombëtar sipas urbanizimit fshat/qytet, dhe gjinisë femra/meshkuj për provimin e Maturës Shtetërore 2022 dhe arritjet Vjetore 2022, për lëndën e Gjuhës së Huaj janë dhënë në formë tabelare edhe grafike, përkatësisht në **Tabelën G-5, Tabelën G-6, Tabelën G-7, Tabelën G-8, si dhe grafikët përkatës.**

Tabela G-5 dhe Tabela G-6 tregon se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore është 22.10%e totalit të nxënësve, prej të cilëve vetëm **2.10%** i përkasin nxënësve të shkollave të fshatit. Ndërkohë, përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor është 20.22%, ku nxënësit e fshatit përbëjnë **2.6%**.

Tabela G-7 dhe Tabela G-8 tregon se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës Shtetërore, është 22.10%e totalit të nxënësve, prej të cilëve vetëm **7.82%** janë djem. Ndërkohë, përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor është **20.22%**, ku djemtë përbëjnë **6.33%** të tyre.

Nga të dhënat e **Tabelës G-5, Tabelës G-6, Tabelës G-7 dhe Tabelës G-8**, si dhe grafikëve përkatës, për lëndën e Gjuhës së Huaj, rezulton se:

- numri i nxënësve në qytet i vlerësuar me notën 4 në provimin e Maturës Shtetërore është (0.63%), ndërsa numri i nxënësve në fshat të vlerësuar po me notën 4 është (0.23%).
- përqindja e mbetësve në provimin e Maturës Shtetërore për kategorinë “meshkuj” (0.68%) është më e lartë se sa për kategorinë “femra” (**0.18%**).
- si në rezultatet e provimit të Maturës Shtetërore, po ashtu edhe për rezultatet vjetore, për notat 8, 9 e 10 të rezultateve të provimit të Maturës Shtetërore, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë “meshkuj”.

Tabela G-9 jep të dhëna mbi shkallën e **paqëndrueshmërisë** së rezultateve Vjetore 2022 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2021-2022) të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës Shtetërore 2022, për lëndën e Gjuhës së Huaj.

Nga **Tabela G-9**, del në dukje fakti që një përqindje e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5, 6 e 7, në provimin e Maturës Shtetërore kanë arritur të marrin vlerësimin 8, 9 dhe 10.

Nga **22.73%** e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, vetëm **7.64%** e tyre kanë mbajtur po atë notë në provimin e Maturës Shtetërore. Ndërsa, prej tyre, rezulton që në Maturës Shtetërore kanë marrë edhe vlerësime me mbi 2, 3, 4 apo më shumë nota.

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

GJUHË E HUAJ

Matura Shtetërore 2022

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
Nota 4	0.23%	0.63%	0.86%
Nota 5	2.27%	5.62%	7.89%
Nota 6	4.49%	9.89%	14.37%
Nota 7	5.63%	14.71%	20.34%
Nota 8	4.13%	13.70%	17.84%
Nota 9	2.58%	16.60%	19.18%
Nota 10	2.10%	19.99%	22.10%


Tabela G-5

Vjetore 2022

Nota	Urbanizimi		Gjithsej
	Fshat	Qytet	
pa notë	0.0%	0.03%	0.04%
Nota 5	6.3%	14.54%	20.85%
Nota 6	4.6%	14.24%	18.82%
Nota 7	3.0%	10.69%	13.74%
Nota 8	2.5%	10.52%	13.02%
Nota 9	2.4%	10.94%	13.30%
Nota 10	2.6%	17.60%	20.22%


Tabela G-6

Grafiku G-5



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për arritjet e Maturës Shtetërore 2022.

Grafiku G-6



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas urbanizimit qytet/fshat për arritjet Vjetore

Përqindjet e notave në nivel kombëtar

GJUHË E HUAJ

Matura Shtetërore 2022

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
Nota 4	0.18%	0.68%	0.86%
Nota 5	2.57%	5.32%	7.89%
Nota 6	5.53%	8.84%	14.37%
Nota 7	8.80%	11.55%	20.34%
Nota 8	9.45%	8.39%	17.84%
Nota 9	10.10%	6.50%	16.60%
Nota 10	14.28%	7.82%	22.10%


Tabela G-7

Vjetore 2022

Nota	Gjinia		Gjithsej
	Femra	Meshkuj	
pa notë	0.00%	0.04%	0.04%
Nota 5	4.37%	16.48%	20.85%
Nota 6	8.85%	9.97%	18.82%
Nota 7	7.70%	6.04%	13.74%
Nota 8	7.79%	5.24%	13.02%
Nota 9	8.30%	5.01%	13.30%
Nota 10	13.89%	6.33%	20.22%


Tabela G-8

Grafiku G 7



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për provimin e Maturës Shtetërore 2022.

Grafiku G 8



Përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas gjinisë për arritjet vjetore 2022.

Tabela G-9

Notat vjetore (në %)		Notat e Provimit të Maturës Shtetërore – Gjuhë e Huaj (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
pa notë	0.04%	0.01%	0.01%	0.00%	0.00%	0.00%	00.0%	0.01%
5	20.85%	0.63%	4.22%	6.60%	6.74%	2.37%	0.26%	0.05%
6	18.82%	0.19%	2.43%	4.57%	6.39%	4.12%	0.92%	0.20%
7	13.74%	0.04%	0.78%	1.94%	3.81%	4.24%	2.27%	0.66%
8	11.62%	0.00%	0.30%	0.87%	0.86%	3.66%	4.04%	1.89%
9	13.30%	0.00%	0.14%	0.33%	0.86%	2.46%	4.93%	4.59%
10	20.22%	0.00%	0.02%	0.07%	0.26%	0.99%	4.19%	14.70%

2) Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj.


Grafiku G-9 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e Maturës Shtetërore 2022 në lëndën e Gjuhës së huaj. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje jonormale të arritjeve të nxënësve. Përqindja e nxënësve që kanë grumbulluar 60 pikë arrin në rreth **2.03%** të totalit të nxënësve.

Grafiku G-9



Shpërndarja e pikëve të fituara në provimin e Gjuhës së Huaj në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku G-10



Shpërndarja kumulative të pikëve të fituara në provimin e Gjuhës së Huaj në Maturën Shtetërore 2022.

Grafiku G-10 paraqet shpërndarjen kumulative të pikëve të fituara në provimin e Gjuhës së huaj në Maturën 2021. Shihet se, në intervalin 50-60 pikë, ndodhen rezultatet e **29.04%** e totalit të nxënësve.

Po kështu, shihet se rreth **14.15%** e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në **intervalin 0 – 25** pikë.

Një tregues kryesor është edhe fakti që 25.65% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin **0- 30** pikë.

Ndërsa në Grafikon G-3.1 shihet se shpërndarja e nxënësve për të gjitha nivelet e notave është thuajse e barabartë me përjashtim të notës 4 ku përqindja e nxënësve për këtë nivel fatmirësisht është tepër e ulët.

Shpërndarja e rezultateve të nxënësve në këtë mënyrë tregon qe testi ka rezultuar më i lehtë nga sa duhej të ishte, por kjo e ka një shpjegim. Testi qëllimisht u ndërtua në një nivel pak më të lehtë nga ai që duhej të ishte për shkak të pandemisë dhe problemeve që ajo mund të shkaktonte në normalitetin e procesit mësimor.

Gjithashtu, nga një studim i të dhënave, në të cilën pasqyrohen pikët për çdo pyetje, vihet re se thuajse të gjitha pyetjet në test kanë funksionuar ashtu si kanë qenë planifikuar me ndonjë përjashtim fare të vogël por jo të qenësishëm.

Në READING COMPREHENSION (Të Lexuarit dhe të Kuptuarit)

Paraqiten DOBËT në:

gjetjen e idesë kryesore dhe mesazheve kryesore që përcjell një tekst;
analizë dhe krahasim tekstesh;
pyetjet me referent (kujt i referohet fjala ose shprehja përkatëse;
analizën e thelluar ose mendimin kritik të asaj që lexojnë;
gjetjen e sinonimit të një fjale ose shprehjeje të shkëputur nga një tekst duke u mbështetur në kontekstin ku ajo fjalë ose shprehje përdoret.

Paraqiten MIRË në:

gjetjen e një informacioni ose një detaji të dukshëm në një tekst të dhënë;
identifikimin e llojeve të ndryshme të teksteve;
krahasimin e informacioneve jo shumë të vështira për t'u kuptuar;
leximin dhe kuptimin e së përgjithshmes së një teksti;
krahasimin e informacioneve jo shumë të vështira për t'u gjetur në tekst;
analizë dhe arsyetim të thjeshtë për tekste jo shumë të vështira për t'u kuptuar.

Paraqiten SHUMË MIRË në:

gjetjen e fjalës ose shprehjes së ngjashme me atë të dhënë në një pjesë të tekstit, kur ajo është shumë e njohur ose e përdorshme;
gjetjen e informacioneve, fakteve dhe detajeve që janë mëse të dukshme në tekst;
gjetjen e fakteve dhe krahasimin e tyre në tekste paralele të shkurtra dhe të thjeshta;
leximin dhe kuptimin e së përgjithshmes së një teksti ku informacioni dhe faktet janë shumë të qarta dhe të dukshme.

Në USE OF LANGUAGE (Në Përdorimin e Gjuhës)

Paraqiten DOBËT në:

kombinimin e kohëve të përbëra;
përdorimin e parafjalëve dhe shprehjeve me to;
përdorimin e lidhëzave si: despite / nevertheless / as.....as / although / unless /etj;
format e kushtores (2nd and 3rd Conditionals);
gjetjen e fjalës së duhur në grup fjalësh me kuptim të përafërt;
format e pësorës me kohë të përbëra;
përdorimin e infinitivit të zhveshur.

Paraqiten MIRË në:

përdorimin e kohëve kryesore të foljeve (Present Tense / Past Tense / Present Perfect / Present Continuous / Past Continuous / Future Tense);
foljet më të përdorshme modale (can / could / may / must);
format e pësorës me kohë të thjeshta;
format e kushtores (0 and 1st Conditionals);
përdorimin e parafjalëve kryesore (in/ on/ at / by / from);

përdorimin e foljeve frazale më të përdorshme (go away, put out, call off, give up, etc).

Paraqiten SHUMË MIRË në:

gjetjen e fjalës së duhur në një grup fjalësh me kuptime të ndryshme;

përdorimin e kohëve të thjeshta;

përdorimin e lidhëzave më të përdorshme (and, but, because, or, etc);

përdorimin e parafjalëve më të përdorshme (in / on / at / to).

Në WRITING (Në Shkrim)

Paraqiten DOBËT në:

fazën e arsytimit mbështetur në fakte.

ruajtjen e koherencës së mendimit ose logjikës në fraza të gjata.

dhënien e konkluzioneve personale me fjali komplekse.

përdorimin e fjalorit të pasur dhe idiomave të ndryshme.

Paraqiten MIRË në:

arsyetimin e thjeshtë të shprehur me fjali jo komplekse.

ruajtjen disi të koherencës e logjikës në paragrafë.

respektimin e fazave të esesë.

shprehjen e konkluzioneve të thjeshta me fjali jo komplekse.

respektimin e shenjave të pikësimit dhe germave kapitale me ndonjë gabim të vogël.

respektimin e shenjave të duhura të pikësimit dhe germave kapitale.

përdorimin e një fjalori të thjeshtë të përditshmërisë së tyre dhe me idioma që janë shumë të përdorshme.

Paraqiten SHUMË MIRË në:

respektimin e fazave më kryesore të ndërtimit të esesë.

përdorimin e lidhëzave të thjeshta si (but / and / because / or) në fjalitë e përbëra.

përdorimin e frazave hyrëse të paragrafëve në ese (firstly, secondly, etj).

në realizimin e temës thjeshtë, pa ndërlikim mendimi.

Diçka e veçantë për t'u vënë në dukje është se nxënësit tanë paraqiten më mirë në shkrimin e një eseje sesa në praktikën e shkrimit të një letre ose email-i zyrtar/formal.

Kjo theksohet në mënyrë që mësuesit të punojnë më shumë me nxënësit në këtë aspekt.

Faktorët që ndikojnë në qëndrueshmërinë të nivelit Mesatar – Mirë.

Kurrikulat tona të hartuara mbi Kornizën Evropiane të Gjuhëve dhe përshtatur me realitetin tonë pa ulur nivelin e pritshmërisë ndaj dijeve të nxënësve;

Përdorimi i teksteve të huaja nga shtëpi botuese prestigjioze në fushën e edukimit;

Njohja dhe zbatimi i formatit të testit të Maturës Shtetërore;

Hartimi i testeve të Maturës Shtetërore bazuar në Kornizën Evropiane të Gjuhëve dhe mbi Programet Orientuese të MSH duke respektuar peshat përkatëse për çdo nivel vështirësie;

Aplikimi i metodës së korrigjimit të pyetjeve me alternativa nëpërmjet korrigjimit me sistemin kompjuterik;

Korrigjimi i testeve bazuar në 2 vlerësues të pavarur nga njëri-tjetri;

2) Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese.

Tabela G-11 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel ZVAP. Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është **39.53** pikë, nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar është **7.75**, ndërsa nota mesatare vjetore në nivel kombëtar është **7.38**.

Të dhënat e **Tabelës G-11** tregojnë se:

- 15 ZVAP kanë mesataren e pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre mbi vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP: Finiq-Dropull, Has, Kavajë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnje, Peqin, Poliçan, Pukë-Fushë Arrës, Shkodër, Tiranë, Tropojë, Vlorë-Himarë.
- 6 ZVAP kanë mesataren e pikëve të fituara në test nga intervali 33.21 pikë- 34.51 pikë nga nxënësit e tyre relativisht nën vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar si ZVAP: Shijak, Kamëz, Malësi e Madhe, Mat, Dibër, Tepelenë-Memaliaj.
- 37 ZVAP kanë mesataren e pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre nën vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si ZVAP Bulqizë, Klos, Belsh, Ura Vajguore, Kuçovë, Selenicë, Skrapar, Maliq etj.

Tabela G-12 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e Maturës Shtetërore në nivel ZVAP e nivel kombëtar, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare vjetore, si dhe diferenca (NM-NV).

Të dhënat e tabelës G-12 tregojnë se:

- 47 ZVAP kanë arritje në provimin e Maturës Shtetërore më të larta se arritjet vjetore. Këtu përmendim ZVAP Poliçan, ku arritjet mesatare të nxënësve kanë një rritje në provimin e Maturës Shtetërore me 1.22 njësi notë krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Më pas, renditen ZVAP Has, Tropojë, Skrapar, Klos, Selenicë etj.
- 5 ZVAP kanë arritje në provimin e Maturës Shtetërore më të ulëta se arritjet vjetore. Këtu përmendim ZVAP Kolonjë e Bulqizë, që kanë arritje mesatare të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore me -0.47 e -0.47 njësi notë krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Më pas përmendim, Kuçovë, Mat, Tepelenë-Memaliaj etj.

Tabela G-13 (e pasqyruar në fund të raportit) paraqet informacion mbi notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale;

gjimnaz me kohë të shkurtuar. Nivelet më të ulëta të arritjeve mesatare në provimin e Maturës Shtetërore i përkasin nxënësve të shkollave teknike profesionale dhe gjimnaz me kohë të shkurtuar. 18 ZVAP kanë notë mesatare mature më të lartë se nota mesatare e Maturës Shtetërore në nivel kombëtar.

Tabela G-14 (e pasqyruar në fund të raportit) jep informacion mbi notën mesatare vjetore në nivel ZVAP, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar. Për notën mesatare vjetore, nxënësit e gjimnazit me kohë të shkurtuar kanë përgjithësisht arritje më të ulëta krahasuar me nxënësit e shkollave të profileve të tjera. 15 ZVAP kanë notë mesatare vjetore më të lartë se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar. 37 ZVAP kanë notë mesatare vjetore më të ulët se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar.

IV. Lëndët me Zgjedhje

1) Arritjet e Nxënësve në Lëndët me Zgjedhje

Në vijim të këtij raporti është dhënë informacion mbi arritjet e nxënësve në lëndët me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2022 për çdo ZVAP. Në raport është përfshirë informacioni mbi arritjet mesatare të nxënësve për ato lëndë me zgjedhje, të cilat janë dhënë provim nga një numër i konsiderueshëm nxënësish. Tabela Z-1 paraqet listën e lëndëve me zgjedhje, numrin përkatës të nxënësve të testuar në çdo lëndë me zgjedhje, të klasifikuar sipas sistemit publik/privat, si dhe përqindjen e kalueshmërisë për secilën nga lëndët.

Nga Tabela Z-1 vëmë re se niveli i kalueshmërisë në këto lëndë me zgjedhje është mbi vlerat 90%.

Tabela Z-1

Nr.	Lënda e Provimit me Zgjedhje	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim (në %)
		Total	Publik	Privat	
1	BIOLOGJI	5974	4886	1088	99.14%
2	EKONOMI	7408	5719	1689	99.48%
3	FILOZOFI DHE SOCIOLOGJI	307	262	45	90.87%
4	FIZIKË	1357	977	380	99.33%
5	GJEOGRAFI	527	517	10	95.82%
6	HISTORI	222	206	16	92.79%
7	KIMI	159	110	49	99.37%
8	QYTETARI DHE PSIKOLOGJI	9896	9192	704	98.09%

Nga të dhënat statistikore të paraqitura në tabelat në vijim, vihet re se:

- nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të larta referuar nxënësve të sistemit publik.
- në nivel kombëtar vajzat kanë arritje më të larta se sa djemtë. Kjo gjetje qëndron si për sistemin publik, po ashtu edhe sistemin privat.
- në nivel kombëtar, nxënësit e qytetit kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e nxënësve të fshatit. Kjo gjetje qëndron si për sistemin publik, po ashtu edhe për sistemin privat.

Informacioni i paraqitur për lëndët me zgjedhje përmban këta tregues:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim
- Nota mesatare e Maturës (NM)
- Nota mesatare Vjetore (NV)
- Diferenca e NM – NV
- Kalueshmëria
- Shmangia standarde - *shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*

Treguesit janë të shprehur:

- në nivel kombëtar:
 - sipas urbanizimit fshat/qytet (që i referohet vendndodhjes së shkollës).
 - sipas gjinisë së nxënësit femra/meshkuj.
 - sipas sistemit publik/privat.
 - në nivel ZVAP

Lënda: Biologji

Tabela B-1 paraqet informacionin statistikor për lëndën me zgjedhje – Biologji. Mesatarja e pikëve të fituara në testim nga nxënësit është 39.08 pikë. Kjo vlerë është pak më e lartë se gjysma e pikëve maksimale të testit. Shihet se diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e 0.59 njësi notë (8.36 – nota vjetore; 7.77 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit Privat të arsimit- kategoria fshat, ku vlera e kësaj difference shkon në 1.31 njësi notë (nota vjetore 9.14, ndërsa nota e maturës 7.83). Ulja e arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, në sistemin Publik, është e lartë për kategorinë e Femra-Fshat, ku diferenca NM-NV= -1.49 njësi notë.

Tabela B-1

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
Total	Femra	40.64	11.46	7.97	1.49	8.68	1.40
	Meshkuj	34.93	12.22	7.22	1.60	7.49	1.89
	Total	39.08	11.94	7.77	1.56	8.36	1.64
Qytet	Femra	42.06	11.01	8.16	1.43	8.84	1.33
	Meshkuj	37.49	11.87	7.56	1.54	7.92	1.80
	Total	40.89	11.41	8.01	1.48	8.60	1.52
Fshat	Femra	36.81	11.77	7.47	1.55	8.28	1.51
	Meshkuj	29.67	11.20	6.53	1.48	6.60	1.74
	Total	34.59	12.05	7.18	1.59	7.76	1.77
	Femra	39.73	11.44	7.86	1.49	8.52	1.44

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

Publik total	Meshkuj	33.36	11.86	7.01	1.56	7.19	1.86
	Total	37.97	11.90	7.62	1.56	8.15	1.68
Qytet	Femra	41.15	11.00	8.05	1.43	8.66	1.38
	Meshkuj	35.82	11.69	7.34	1.53	7.58	1.84
	Total	39.79	11.42	7.86	1.49	8.38	1.58
Fshat	Femra	36.66	11.77	7.45	1.55	8.22	1.51
	Meshkuj	29.42	11.05	6.50	1.46	6.56	1.74
	Total	34.36	12.02	7.15	1.58	7.69	1.77
Privat total	Femra	44.58	10.70	8.48	1.36	9.40	0.93
	Meshkuj	42.62	10.96	8.23	1.40	8.96	1.19
	Total	44.08	10.80	8.42	1.38	9.29	1.02
Qytet	Femra	45.00	10.53	8.53	1.34	9.41	0.93
	Meshkuj	42.72	10.87	8.24	1.39	9.00	1.18
	Total	44.41	10.66	8.46	1.36	9.30	1.01
Fshat	Femra	39.43	11.53	7.82	1.50	9.31	0.98
	Meshkuj	40.42	13.17	7.92	1.65	8.25	1.22
	Total	39.59	11.72	7.83	1.51	9.14	1.08

Tabela B-2 paraqet arritjet mesatare të provimit të maturës dhe vjetore për lëndën Biologji në nivel ZVAP. Arritje të mira me mbi 45 pikë në testin e maturës dhe me qëndrueshmëri të lartë të notës kanë ZVAP-të Malësi e madhe, Kavajë Peqin dhe Tropojë.

Tabela B-2

Nr.	ZVAP	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
1	BELSH	39.44	9.68	7.86	1.30	8.56	0.73
2	BERAT	35.28	10.37	7.27	1.35	8.25	1.69
3	BULQIZË	33.23	13.25	6.99	1.79	8.56	1.48
4	CËRRIK	35.72	10.91	7.34	1.44	7.27	1.60
5	DEVOLL	38.64	10.20	7.72	1.32	7.44	1.84
6	DIBËR	40.76	13.14	7.95	1.65	8.62	1.42
7	DIVJAKË	35.64	9.17	7.34	1.23	8.60	1.53
8	DURRËS	43.83	10.73	8.39	1.38	8.68	1.45
9	ELBASAN	34.86	12.60	7.21	1.67	8.10	1.65
10	FIER	40.11	12.63	7.90	1.64	8.78	1.39
11	FINIQ-DROPULL	36.71	13.57	7.43	1.75	9.29	0.99
12	GJIROKASTËR-LIBOHOVË	39.24	11.87	7.77	1.53	8.82	1.49

Raport Publik mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2022

13	GRAMSH	40.43	9.63	7.97	1.28	7.97	1.60
14	HAS	38.63	6.89	7.72	0.91	8.54	1.53
15	KAMËZ	32.36	10.91	6.89	1.47	7.86	1.64
16	KAVAJË	46.75	9.43	8.77	1.20	8.17	1.53
17	KLOS	43.27	9.87	8.33	1.28	8.32	1.64
18	KOLONJË	38.45	8.45	7.73	1.15	9.09	0.83
19	KORÇË - PUSTEC	36.17	11.24	7.42	1.49	8.65	1.60
20	KRUJË	39.80	12.95	7.85	1.69	8.52	1.71
21	KUÇOVË	29.57	11.95	6.51	1.63	7.89	1.79
22	KUKËS	44.24	10.73	8.43	1.37	7.44	1.84
23	KURBIN	43.04	10.40	8.30	1.35	8.03	1.67
24	LEZHË	34.87	11.93	7.21	1.59	8.53	1.66
25	LIBRAZHD	33.76	8.23	7.08	1.08	8.29	1.46
26	LUSHNJE	39.57	12.06	7.83	1.57	8.14	1.86
27	MALËSI E MADHE	51.53	7.52	9.23	0.83	9.53	0.72
28	MALIQ	32.86	10.22	6.98	1.40	7.96	1.63
29	MALLAKASTËR	33.53	9.23	7.04	1.23	8.28	1.62
30	MAT	31.02	6.12	6.73	0.81	8.59	1.37
31	MIRDITË	38.91	12.23	7.75	1.64	8.68	1.73
32	PATOS	34.72	10.17	7.20	1.32	8.07	1.88
33	PEQIN	46.39	12.00	8.63	1.48	8.21	1.60
34	PËRMET- KËLCYRË	37.55	14.15	7.53	1.82	7.78	2.02
35	PËRRENJAS	36.02	12.30	7.38	1.66	7.60	1.67
36	POGRADEC	33.15	10.93	7.01	1.45	8.05	1.76
37	POLIÇAN	35.28	7.59	7.29	1.02	8.67	1.97
38	PUKË-FUSHË ARRËS	39.35	11.45	7.85	1.55	7.67	1.66
39	ROSKOVEC	35.71	9.57	7.34	1.26	7.66	1.83
40	RROGOZHINË	35.33	9.10	7.29	1.21	7.41	1.79
41	SARANDË- DELVINË- KONISPOL	42.02	11.25	8.18	1.50	9.00	1.33
42	SELENICË	44.70	4.74	8.57	0.69	7.50	1.43
43	SHIJAK	37.25	10.55	7.54	1.41	8.21	1.34
44	SHKODËR	39.48	11.67	7.84	1.55	8.37	1.61
45	SKRAPAR	29.91	8.42	6.56	1.13	8.74	1.51
46	TEPELENË- MEMALIAJ	39.28	9.32	7.81	1.23	8.66	1.52
47	TIRANË	42.95	11.57	8.26	1.48	8.98	1.23

48	TROPOJË	45.48	6.37	8.66	0.86	9.52	0.90
49	URA VAJGURORE	28.05	12.41	6.33	1.66	7.36	1.47
50	VAU DEJËS	25.05	10.30	5.92	1.44	7.10	1.73
51	VLOREË-HIMARË	44.44	10.97	8.46	1.41	9.17	1.29
52	VORË	32.83	6.78	6.96	0.88	8.52	1.21

